

INTERVISTË ME SKENDER VARDARIN

Prishtinë | Data: 2 mars, 2022

Kohëzgjatja: 145 minuta

Të pranishëm:

1. Skender Vardari (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Skender, nëse mundeni me u prezantu? Me na tregu datën, vendin e lindjes, diçka për familjen e ju, prejardhjen?

Skender Vardari: Po, unë quhem Skender Vardari. Jam i lindun me 15 gusht 1961 në Stamboll. Jom bir i një familje që osht' shpërngulë në vitin 1956, në kohën e shpërnguljes masive që është bo nga trojet shqiptare në drejtim të Turqisë. Atëherë, prindtë e mi i kanë pasë vetëm dy çika, gjegjësisht motrat e mija ma të mdhaja se unë. Me dy çikat e tyne kanë dalë në Stamboll.

Anita Susuri: Prej cilit vend kanë dalë?

Skender Vardari: Prej Prishtinës. Përndryshe, prejardhjen e kemi me ni katun Bakshi i thojnë, quhet Bakshi edhe ai katun është në afërsi të Prishtinës. Sepse fillimisht kanë dalë prej Bakshisë në Prishtinë edhe pastaj prej Prishtinës janë shpërngulë në Turqi. E në Turqi, fëmiu i tretë kam qenë unë që kam lindë atje në Stamboll. Pas meje kanë lindë edhe tri motra të mija, gjegjësisht domethonë kemi qenë pesë motra edhe unë me prindtë. Une...

Anita Susuri: A ju kujtohet ndoshta, po ju ndërpres, ndonjë tregim i prindve të ju ose qysh ka ndodhë kjo shpërngulje? A i ka detyru dikush apo vet kanë marrë vendim? Qysh ka ndodhë kjo?

Skender Vardari: Krejt kto ngjarje se si kanë dalë prindtë e mi s'bashku me familjet tjera që janë shpërngulë në kohën e shpërnguljeve masive të kohës së Rankoviqit i kam mësue më vonë. Sepse gjatë kohës sa kemi jetu në Turqi, ne si familje, unë gjuhën shqipe nuk e kam ditë. Kam fillue që të flas vetëm në gjuhen turke deri në vitet e '70-a. Në '72-tën jemi kthye nga Turqia për në Kosovë. Atje e kam krye shkollën fillore pesë-vjeçare, se atëherë ishte fillorja në Turqi pesë-vjeçare në gjuhën turke. Gjuhën shqipe kom fillue me e mësu këtu, masi jemi kthye në Kosovë. Ndërkohë kem vazhdu jetën në Kosovë. Jam regjistru në shkollën fillore ktu përsëri, vazhdimin e shkollës fillore domethonë nga klasa e shtatë në gjuhën shqipe. Edhe shkollën e mesme e kam krye ktu në Kosovë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë, në cilin vend në Turqi keni qenë edhe qysh ka qenë qajo fëmijëria në Turqi? Qysh kanë qenë kushtet për juve? Me çka janë marrë prindtë?

Skender Vardari: Kushtet deri dikun e kemi pasë ni mesatare me sa më kujtohet mua, me përjashtim të kohës së fundit, domethonë viteve të fundit të jetës në Turqi. Atëherë baba im ka punu, domethonë punë fizike edhe në punë të ndryshme. Punë fizike ka punue edhe ni kohë. Meqenëse ka qenë edhe i pa punë, na osht’ prish gjendja ekonomike e familjes tonë edhe ka ardhë ni dajë i imi nga Kosova për në Stamboll. Na ka propozue që të kthehemi në Kosovë edhe përkohësisht që të kthehemi në Kosovë.

Gjatë kohës që do të na mbikqyrte daja im, babai im ka pasë në plan përmes dajës, përmes të njohurve të dajës tim, ka pasë për të shku në Gjermani. Atje që të punoj në Gjermani babai, e ne të vazhdojmë të jetojmë ktu në Kosovë. Jo me domosdoshmëri, jo me paramendim që të kthehemi përgjithmonë në Kosovë. Por, ndërkohë ne fëmijtë u regjistruam në shkollë. Babai filloi me punu atje në Gjermani edhe gjuhën fillova ta mësoj unë, gjuhën shqipe. Ndërkohë, babai shkonte e vinte.

Ndër vite, pas disa viteve babai ka shkue ta vizitoj Stambollin, por në Stamboll i kisha unë... kur jemi kthyer faktikisht nga Stambolli, mu më kanë pasë mbetë atje dy motra. Edhe kur ka shku me i vizitu motrat e mija, babai im atje ka kontaktue edhe me shqiptarë tjerë, me të afërm, me fqinjë, me shokë. Ndër të tjerë, ka pasë, ne kem pasë edhe shoqatë atje, Shoqata e Vllazërisë Turko-Shqiptare në Stamboll. Edhe kish pasë shkue me vizitue shoqatën babai im. Për këtë vizitë që po flas une i takon përafërsisht rreth viteve, në klasën e tretë të shkollës të mesme për mua.

Atje babai ka kontaktue ni përfaqësues të Konzulatës të Shqipërisë së asaj kohe. Ai ishte ky ambasador apo konzul, apo edhe dikush tjetër nga përfaqësuesit e Shqipërisë që kishin pasë ardhë me vizitu shoqatën edhe në shoqatë ka kontaktue edhe babai im me ta. Në bisedë e sipër, babai im i tregon atij përfaqësuesit të Shqipërisë që, “Unë”, thotë, “jom kthyer në Kosovë, e kom kthyer familjen në Kosovë edhe jam i interesuar”, thotë, “e kom vetëm ni djalë që ta shkolloj në Kosovë, djalin”. Edhe ai përfaqësuesi i Shqipërisë kur e sheh që ky osht’ i interesuar që ta shkolloj djalin e vet, domethonë, ni mërgimtar siç e ka konsideru në atë kohë familjen tonë, siç ishim në të vërtetë. Edhe i ofron libra. Thotë, “Meqenëse je i interesuar që ta shkollosh djalin në Kosovë atje, t’i jap”, thotë, “unë disa libra që t’ia dërgosh atij djalit atje”, ky thotë, “Po, me gjithë qef”. I jep libra.

Tash numrin e librave nuk më kujtohet mu se isha i ri në atë kohë. Por ni libër, disa, shumë libra të konsiderueshëm, domethonë literaturë edhe asi literature të gjitha kanë qenë të ndalume n’atë kohë. Literaturë e ndalume në atë kohë prej Jugosllavisë i ka dhanë babait tim. Babai im m’i ka sjellë nga Stambolli në Kosovë. Pra, pikënisja, unë besoj, e frymëzimit tim kombëtar ka fillue që ta ketë ni temel të sigurt nga sjellja e atyre, e asaj literature që i kanë dërgu përfaqësuesit e Shqipërisë atje. Kështu ka fillu interesimi im për çështjen kombëtare qysh si i ri. Pastaj...

Anita Susuri: A ju kujtohet çfarë libra kanë qenë? Sigurisht Gjergj Fishta? Naim Frashëri?

Skender Vardari: Për Gjergj Fishtën nuk e kemi pasë, se në atë kohë Gjergj Fishta as në Shqipëri nuk ka qenë. Me përjashtim të Gjergj Fishtës kemi pasë shumë libra tjerë. Libra për Mic Sokolin, qaq shumë ka pasë libra ma shumë se, mund të them 30-40. Mund të jetë edhe ma shumë libra që ka sjellë babai. Ato libra jo vetëm që i kom lexu une, po ndërkohë tani kur i mësova që janë të ndalume ato libra edhe nga përmbajtja e jom njoftë që janë të ndalume duke i pa në rrethanat ku jetojmë na në Kosovë, si i ri.

Kom fillu edhe t'i shpërndaj në mënyrë ilegale, po me vetë iniciativë, jo në mënyrë të organizume. Edhe në bazë të atyne librave unë kom kriju rreth njerëzish që me të vërtetë kanë qenë të interesum për çështjen tonë të pazgjidhur kombëtare në kohën e Jugosllavisë. Edhe në ndërkohë, në mënyrë të natyrshme por gjithnji ilegale është kriju ai rreth. E derisa kom arritë në kontakt edhe me njerëz që kanë qenë të organizum nëpër organizata të ndryshme.

Tani kemi shkëmbye literatura nga se kom dhanë unë literaturë të ndalume të asaj kohe edhe kom marrë literaturë edhe dokumente, shkrime të ndryshme të organizatave të ndryshme të asaj kohe. Kështu që, jom futë në ilegalitetin në organizime të ndryshme, jo shumë, domethonë të karta. Siç e bon çdo i ri hapat e parë të organizimit të veprimtarisë së vet individuale.

Anita Susuri: Para se me vazhdu edhe te aktiviteti po du edhe me u kthy në do pjesë të mahershme se po mendoj që janë me rëndësi kthimi prej Turqisë. Qysh e keni përjetu ju edhe çka keni pritë prej këtij vendi domethonë? Çka ka qenë mendimi ju në atë kohë si fmi?

Skender Vardari: Si fmi unë nuk kom pasë përcaktime të qarta. Jo vetëm që s'kom pasë përcaktime të qarta, po edhe gjuhen shqipe nuk e kam ditë. Unë ktu kur kom ardhë kom fillue ta mësoj gjuhën shqipe. Kështu që, nuk kom pasë kurfarë ideje se pse osht' shpërngulë familja ime nga Kosova për në Turqi, pse kemi jetu ne në Turqi edhe si osht' e mundur që unë nuk e kam ditë gjuhën shqipe. Kto terme për mu kanë qenë të panjoftuna. Domethonë, mund të konsideroni ni fmi pothuajse komplet i, pa ndjenja kombëtare, i, si me thanë osht', kur... me identitet të huj. Domethonë, unë vetën edhe shqiptar nuk e kam konsideru si fmi, gjithmonë kom mendu se jam turk. Krejt kto ndryshime të mdhaja te une janë bërë pasiqë jam kthy prej Turqisë. Gjegjësisht, domethonë familja jonë masi u kthye prej Turqisë.

Anita Susuri: E në vendin ku keni jetu në Turqi, a ka pasë edhe aty shqiptarë tjerë? A ka pasë naj komunitet?

Skender Vardari: Po me siguri në Stamboll kur jom bërë i vetëdijshtëm pas 18 viteve të jetesës në Kosovë unë jam kthye në Stamboll për vizita të ndryshme disa herë. Por, atëherë e kom kuptue që në Stamboll ka shqiptarë edhe shqiptartë e Stambollit, gjegjësisht edhe në përgjithësi të Turqisë janë të shpërngulur kryesisht nga trojet shqiptare. Por, për kohën që po flasim për kthimin e familjes tonë, gjegjësisht për veti në atë kohë kur jemi kthy ne kam qenë fmi dhe nuk kam ditë lidhur me këto të dhana asgjë.

Anita Susuri: E kur jeni kthyer në Prishtinë, a jeni kthyer në vendin ku keni jetuar ma herët para se me shku apo si kjo ka ndodhë?

Skender Vardari: Jo. Nga bisedat me prindtë e mi unë e kam pasë të qartë që babai im ka dalë nga Bashkia duke mos marrë asgjë, as pronësi, as... sepse në atë kohë kur janë shpërngulë tani nga këndvështrimi i sotshëm edhe disa viteve të mahershme, unë e kuptoj që në atë kohë prindtë nuk kanë dalë që të kthehen ma. Sepse shpërnguljet edhe presioni kishte qenë i tillë sa që kanë hjekë dorë ma që të jetojnë në Jugosllavinë e asaj kohe.

Prandaj, kur jemi kthyer ne nuk kemi pasë pronësi ktu kurgjo. Kemi filluar nga zeroja duke bërë nëpër disa shtëpi me qira, më vonë kemi blerë trolle, kemi ndërtoqur në shtëpi në Prishtinë edhe kemi vazhdu jetën deri në momentin kur më kanë depërtuar prej Kosovës përsëri pas shumë viteve. Kështu ishte, domethënë gjendja edhe fillimi i jetesës së familjes sonë në kohën e kthimit nga Turqia.

Anita Susuri: E çka ju kujtohet, për shembull kur jeni ardhë ktu? Qysh ka qenë për juve? Keni vazhdu në gjuhë tjetër? Gjuhën e juaj domethënë amëtare po qysh ka qenë për juve ky përjetim?

Skender Vardari: Po. Si fmi besoj jo i lehtë. Megjithatë, rrethanat ishin në favor timin që ta ndryshoj gjuhën t'i kthehem gjuhës amëtare. Edhe ambienti ku jetoja tani ishte ambienti i familjarëve të mi, jo vetëm familjes së afërme, por edhe farefisit. Të gjithë kanë qenë... kanë drejtimin e duhur që të mos e përjetoj atë ndryshimin shumë të madh si fmi. Domethënë, në mënyrë të natyrshme iu kom përshtatë jetës në Kosovë. Sepse edhe sot e asaj dite kam bindjen që njerëzit... që si fmi që kam qenë i asimilum... shigjeta kur është në drejtimin e bazës, në drejtimin e unit njerëzor është ma e lehtë sesa ta marrësh një shigjetë në një rrugëtim tjetër jashtë unit tond, domethënë jashtë identitetit tond. Na kemi edhe sot e asaj dite shpërngulje nga Kosova në shtete të ndryshme për shkaqe tjera ekonomike kryesisht. Por, që janë besoj ma të dhimbshme, ma të zorshme sesa ajo që e kom përjetu unë kur jemi kthyer prej Turqisë.

Anita Susuri: Në cilën shkollë në Prishtinë keni vazhdu shkollimin?

Skender Vardari: Shkollën fillore, "Zenel Hajdini", në një lagje tash quhet Kodra e Trimave, aty e kom vazhdu domethënë filloren. Edhe pastaj shkollën e mesme ktu te, atëherë ishte "19 Nëntori" më doket, atje e kmi kry. Pastaj i kemi bërë edhe disa ndryshime gjatë shkollimit të mesëm dy vjet e para ktu te "19 Nëntori", pastaj kemi dalë dy vjet e fundit atje te Taukbashçja ka vazhdu. E nejtja shkollë po kam vazhduar si gjeneratë e kuantin atëherë si gjeneratë eksperimentale. Sepse para nesh, gjeneratat para nesh ishin domethënë me orientime të duhura që nga viti i parë i shkollës së mesme. Ndërsa gjenerata jona e patëm në fat të tillë që të bëjnë ndryshime. I takum ndryshimeve të gjeneratave të asaj kohe.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atmosfera në Prishtinë? Se në '74-tën është kushtetuta kur është bo për Kosovën edhe në anën politike ka qenë në situatë pak ma e mirë se në periudhën e Rankoviqit, domethonë edhe në atë periudhë të viteve të '60-ta. Qysh e keni pa ju në shoqëri për shembull, në rrethin ku keni jetu? Qysh ka qenë qajo periudhë?

Skender Vardari: Meqenëse unë para vitit, kohën para viteve të '74-ta nuk e kam përjetue, domethonë dy vjet përpara kemi ardhë në ktu por si fmi, si nxanës edhe si fmi nuk kom mujtë me përceptue se çfarë janë ato ndryshime. Më vonë tani jom pajisë me të dhëna edhe informacione me, gjatë leximit e tjera, që i kam kuptu ato ndryshime më vonë. Mirëpo, jo duke e parë atë ndryshim sepse unë kam qenë i vogël atëherë. Po kryesisht vetëdija kombëtare te une ka fillue gjatë shkollës së mesme edhe ata pas vitit të dytë, të tretë, të katërt e të tjerë. Prandaj, nuk e, nuk kam mund ta përceptoj atë ndryshimin që e ka përjetu populli shqiptarë me ndryshime kushtetuese të vitit '74.

Anita Susuri: Ju thatë që keni fillu shkollën e mesme fillimisht me i lexu kto literatura që ju ka sjellë baba ju. Po qysh ka fillu tani krejt ky aktiviteti? Keni pasë shoqni apo?

Skender Vardari: Me nifarë gradualiteti që osht' vështirë të shpjegohet nga kjo distancë kohore tani. Sepse kemi qenë, unë besoj, kom bindje që kemi qenë në gjeneratë e jashtëzakonshme për shumë arsye. Kemi jetue në ato rrethana saqë me i evidentue ka qenë pothuajse gati e pamundur as ndjenjat, as kronologjinë. Prandaj edhe kom vështirësi, përveç tjerash, me folë në vetën e parë edhe për këtë shkak. Sepse kemi pasë në jetë plot peripeti, ndoshta mund të thuhet edhe vujtje me siguri por edhe ndryshime, kohë e ndryshimeve të mdhaja. Edhe në kohën e ndryshimeve të mdhaja me qenë njëri ndër protagonistët, sot do të thoja, të vogël ishte në ndjenjë e veçantë por shumë çka edhe të pashpjegueshme. Është vështirë që t'i kthehet domethonë, shumë herë besoj duhet t'i kthehet njeriu vetëvetës edhe ta sheh detajet një nga një për me mujt me arritë diçka sepse edhe koha e bon, harresa e bon të vetën.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë krejt qajo? Çfarë aktiviteti edhe a ju kujtohet fillimi?

Skender Vardari: Fillimi zakonisht pak është e zbehtë kujtesa, por megjithatë do të mundohet ta them që fillimi ka qenë më shumë me shoktë dhe shoqe të gjeneratës duke bisedue për tema të ndryshme. Edhe nga ato libra që i kemi lexue kemi shkëmby mendime ndër të rinjtë, ndër shokë e shoqe. Aty fillon shtjellimi i temave të ndryshme, aty fillon kjarësimi, orientimi edhe politik edhe kombëtar edhe gjithçka edhe për fusha të tjera. Domethonë, ne kem bisedue siç është normale biseda e çdo të riu edhe për kulturë edhe për sport edhe për gjithçka tjetër por duke u... karakteri i njeriut unë besoj që formohet edhe nga edukata e shkollimit që ke pasë edhe nga leximi i librave, siç e thashë përpara edhe nga biseda edhe nga mënyra e jetesës së asaj kohës qysh e kemi pasë e tjerë e tjerë. Domethonë, fillimi i aktivitetit tim kryesisht bazohet në biseda të ndryshme me shokë dhe shoqe.

Anita Susuri: Qysh ka qenë, për shembull në iniciativë me bo diçka?

Skender Vardari: Edhe iniciativa për të bo diçka mendoj që ka ardhë ma vonë. Ma së pari, para se të gjithash temat që i kemi shtjellue mes veti zakonisht i kemi trajtu temat qysh janë, jo qysh do të bohet, por qysh janë. Por sa herë që kem diskutue, sidomos tema që i përkasin çështjes shqiptare në Jugosllavi edhe pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi ajo pak a shumë e ka nxjerrë pyetjen se çka do të bohet ma vonë, çka duhet të bëhej më tej. Prandaj, edhe osht' ni periudhë tjetër e hulumtimeve, e bisedave, e trajtesave të ndryshme që i kemi pasë na shoktë mes veti se çka do të bohet, çka duhet të bohet ka ardhë gjithnji ma vonë.

Por, kësaj i ka parapri edhe një masë shumë e madhe një kohë të gjatë se qysh osht' gjendja e tanishme, duhet të them për atë kohë. Jo të tanishme të sotshme, por për atë kohë. Ajo ka marrë ni periudhë bukur të madhe e pastaj ka ardhë periudha tjetër. Periudha tjetër sikur osht' më e lehtë se çka duhet të bëhet. Sepse njeriu si i ri e ndjen atë gatishmërinë që të bëjë diçka, që të veproj diçka, të të kontriboj diçka derisa edhe vet osht' pjesëtari i qasaj shoqërie.

Anita Susuri: Në cilin vit ju jeni inkuadru në ilegalitet?

Skender Vardari: Në vitet '78, besoj mund të jetë pak a shumë edhe '77-tshi, por '78-shi kryesisht ma kjojtë është '78-shi. Mirëpo, nuk ka zgjatë shumë sepse organizimin nuk e kemi pasë të duhun, jo vetëm unë po secili kom përshtypjen. Tani bisedojmë me shokë tjerë edhe në këtë kohën e vonshme kështu sikur shumica e shokve kanë kalu nëpër qat' periudhë përafërsisht të njëjtë. Domethonë është një kohë që vepron edhe pse ilegal, por jo në mënyrë shumë të organizime edhe në kushte edhe rrethana të kohës që e kemi përjetu ne ka qenë kohë e vështirë.

Unë nga këndvështrimi i sotshëm, sikur të më kish thanë dikush tash, a do të kishe fillue atë veprimin ilegal ashtu siç e kam fillu atëherë, nuk do të guxoja besoj. Por atëherë guximi i të riut ishte ndryshe. Jo vetëm i të riut që ka qenë ndryshe edhe atëherë edhe sot është. Domethonë, të ritjë janë ma të prirur ma të guximshëm. Por edhe nga se e kishim ni, unë për veti kom pasë përshtypjen që, domethonë ke të bojsh me ni pushtues por jo në atë përmasë çfarë kishte qenë në realitet. Sidomos përcjellja, sidomos shpiunimi, rrjeti i përcjelljes së UDB¹-së në atë kohë kishte pasë qenë në çdo pore të jetës, gjë që ne nuk e kemi përceptu të tillë.

Prandaj, kemi pasë edhe gatishmëri ma të madhe se boj diçka edhe nuk më sheh kush ose domethonë nuk do të kem pasoja që do të boj shumë veprime pa pasur pasoja. Atëherë pra, unë do të ndalem pak edhe në këtë periudhën e mahershme të bisedave me shokë dhe shoqe. Se kjo, në, sa i përket frymëzimit gjatë bisedave me shokë dhe shoqe ne kemi, jemi frymëzu vazhdimisht në rrethana të ndryshme ku kemi jetu.

¹ Shërbimi i Sigurimit Shtetëror - *Služba državne sigurnosti*, i njohur gjithashtu me emrin e tij origjinal si Administrata e Sigurimit Shtetëror, ishte organizata sekrete e policisë së Jugosllavisë komuniste.

Tash viti '78, '79 jo vetëm nga këto libra që jemi frymëzue, por jemi frymëzue edhe nga disa arsimtarë e profesorë që kemi pasë. Tani jemi frymëzue edhe nga shumë burime. Kem fillue që t'i përcjellim lajmet, këngët që janë këndue në Radio Televizionin Shqiptar, Radio Tiranën, Radio Kukësin, sidomos Radio Tiranën. Jem mundue që të shkojmë nëpër disa edhe katune të largëta që kanë pasë, që kanë qenë larg prej Prishtinës, por që iu kanë shmang atyne pengesave që ka pasë paraqitë.

Koha e sundimit jugosllav ka pasur disa pengesa lidhur me antena që t'i pengon valtë që kem mujtë me i shfrytëzu na për me dëgjue Radio Tiranën. Edhe nga ata jemi frymëzue edhe kangtë që janë këndu atje i kemi përcjellë. Përmes këngës na shumëçka të historisë, së popullit shqiptarë e kemi mësue edhe prej këngës që e kanë transmetu atje në Shqipërinë e asaj kohe. Ndërkohë kanë ardhë vizita të ndryshme të shoqërisë, shoqërive kulturo-artistike të Shqipërisë këtu na kanë, që kanë dhanë koncerte të ndryshme. Kemi marrë pjesë në koncerte të tyne me emocione i kemi përcjellë ato.

Gjithçka në jetë, në jetën e përditshme kemi pasë burime të frymëzimit. Merre me mend edhe veshja ndryshe e tyne modeste, por që i takon ni shoqërie që osht' ma me kulturë në sytë tanë e shihnim të tillë çdo njeri që vinte nga Shqipëria. Ngarendim edhe t'i vizitojmë ne këtu, sepse nganjëherë vinin te Hotel Grandi ktu në qendër të Prishtinës edhe shkonim t'i vizitojmë aty. Na jepnin shenja që i vendosnim ne shenja të ndryshme zakonisht me flamuj. Gjithçka ishte, domethonë shumë faktorë që për momentin mundet mos t'më kujtohen mu të gjitha, po kemi pasë shumë burime të frymëzimit. Pothuajse shumica ilegale, mirëpo që jemi ushqye me ndjenja kombëtare.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ishit t'u na tregu për organizata të ndryshme shoqërore, kulturore, artistike që kanë ardhë prej Shqipnisë edhe qysh ju i keni pritë edhe interaksionin me ta që keni pasë.

Skender Vardari: Po, kjo, deshta me përmend ktu me qëllimin që ta arsyetojmë ato burimet e frymëzimet tona e të gjeneratave tona. Kto na kanë bërë, na kanë frymëzue edhe na kanë pregaditë edhe na kanë... ka ndiku te ne që të ndryshojmë edhe ne edhe në mënyrën e sjelljes edhe në mënyrën e veprimeve që jo çdo gja për shembull me një, me një shenjë të flamurit që ta vendosësh në gjoks je kombtarisht në rregull. E shinin gjatë takimeve që nuk mjaftoheshim tani vetëm me simbole, vetëm me sjellje, vetëm me orientime të përkatësisë kombëtare.

Por, sa më shumë që thelloheshe në bisedat me shokë që kishin orientime edhe gatishmëri që të veprojnë, që t'i shtynjë proceset përpara e shihnim mungesa tona edhe e shihnim se duhet të veprohet edhe në mënyrë ilegale, sa ma msheft që është e mundur edhe ma të organizum, sepse kishim... ndëgjoni pastaj edhe burgime, burgosje marrje në pyetje e tjera. Domethonë, pasojat dalë ngadalë i vrenim se do të kemi pasoja të mëdha. Kështu ka fillue domethonë fillet e para të ilegales, përafërisht kanë qenë të tilla.

Anita Susuri: Qysh ka qenë organizimi brenda?

Skender Vardari: Organizimi, unë nuk kam arritë që të kem me një rreth dhe shokë të caktum që kanë qenë me të vërtetë të, që i kanë, që i kanë takue në organizate e në organizim të mirëfilltë. Edhe pse kom pasë shokë që kanë qenë të organizum, por për shkaqe të ndryshme unë kom refuzue që të jem pjesë e në organizatës për disa arsye, jo gjithsesi. Jo për shkak të mosgatishmërisë time për të veprue, po për shkaqe sigurie. Domethonë e kom pasë në shok, për shembull shok shumë të ngushtë që ka qenë i organizum në në organizatë por që unë i kom pasë ato dilemat e mija personale e që të jem pjesë e asaj organizate apo jo.

Por, megjithatë gatishmëria ishte më e madhe se ato dilemat e mija që i kisha për atë kohë. Kështu që, edhe pse nuk isha anëtar i asaj organizate fillova të kontriboj edhe për atë organizatë që nuk isha anëtare. Kom marrë pjesë, për shembull meqenëse kam qenë student i shkollës së mesme të ndërtimtarisë mu më shkonte vizatimi teknik mirë. Edhe e mbaj në mend që stemën, një stemë e kem, e kam bërë vet unë për atë organizatë. Ishte një stemë me synime që do ta, do të jetë në një të ardhme e Republikës së Kosovës.

E kom marrë materiale të asaj organizate, programin, statusin e tjerë e disa revista që tani nuk më kujtohen shumë sa kom marrë, domethonë dokumente të asaj organizate. Jom njoftë me veprimtarinë e asaj organizate përmes atij shokut edhe kom dhanë kontributin tim modest lidhur me aktivitetet e asaj organizate. Por, pa qenë anëtar. Pastaj me në rast tjetër, si shembull po e përdor nashta po e prishi kronologjinë por më ra në mend që kemi marrë në trakt të në organizate krejtësisht tjetër që nuk kishte të bëjë kjo me këtë të parën. Një trakt që bënte thirrje për do përsëritjen e demonstratave të '81-shit shembull.

Ato e kem marrë unë me disa shokë s'bashku në mënyrë më primitive. Kemi përdorë shumëzimin e atij trakti e kemi shumëzuar vet, e kemi shpërndarë vet edhe ma në fund në aksion jam i zanun vet. Unë jam zanë në aksion të shpërndarjes së trakteve për trakteve të demonstratave të '82-shit domethonë. Bënte thirrje për përsëri me dalë në demonstrata në '82, në mars të '82.

Anita Susuri: Ai ka qenë viti që jeni burgosë apo?

Skender Vardari: Po, po. Viti i burgosjes ka qenë ai.

Anita Susuri: Po paraprakisht po du me folë pak edhe për këto, shembull aktivitetet edhe rreziqet që iu kanë kanosë para burgosjes?

Skender Vardari: Para burgosjes, unë, kemi pasë aktivitete edhe gjatë viteve '78-'79. Shembull, me disa shokë të tjerë gjithashtu të, domethonë të përzgjedhun pak a shumë në atë sistemin e asaj kohe

osht' bërë, mbaj mend që është bërë ni organizim i seleksionimit të nxënësve ma të mirë të asaj kohe. Ata nxënës kanë shkue në Pallatin e Rinisë së sotshme në atë kohë quhej, ishte Boro Ramizi. Atje ka pasë disa grupe hulumtuese të rinjë.

Nxënësit që i përbënin ato grupet e hulumtuesve të rinjë, kryesisht ishin të përzgjedhur si nxënës, pothuasje gati ma të mirtë të Prishtinës. Ka pasë grupe të historisë, gjuhë dhe letërsi, astronomi, matematikë edhe nuk më kujtohet edhe disa tjera më duket. Po krejt degët tani nuk më kujtohet, se ka kalu kohë e gjatë, por që ato grupe faktikisht kanë qenë legale edhe e kanë shfrytëzue objektet legale, domethonë si objektet e kulturës ka qenë ai i rinisë dhe sporteve.

Por, ne kemi shku nëpër ato grupe edhe kemi majt biseda. Bisedat i kemi shndërru në mbledhje të fshehta dhe grupet e hulumtuesve kemi pasë synim në një të ardhme, sa ma shpejt që është e mundur, t'i shndërrojmë të gjitha ato grupe punuese të hulumtuesve të degëve të historisë. Për shembull, aty osht' majt ni program mësimor sikurse në çdo shkollë por vetëm osht' kufizuar domethonë historia e popullit shqiptar. Edhe pjesa ma interesante, ma delegate osht' shpjegue më shumë është shpjegu, për shembull, vitet kur, e Lidhjes së Prizrenit e tjera.

Gjithnji me qëllim që ata nxanës të mirë të shndërrohen nesër, masnesër në veprimtarë të mirëfilltë që i kontribuojnë çështjes kombëtare. Kështu e kem pasë synimin. Aty UDB-a na ra kështu, na hetoi që po vepronim ne, edhe pse jo shumë të organizum përsëri po them. Po fillunë që të na marrin në pyetje. Ndër të tjerë më kanë marrë në pyetje edhe mu shumë herë. Mbaj mend një UDB-ash, gjegjësisht atëherë nuk quheshin UDB-ash, janë qujtë njerëzit që kanë punu në Sigurimet Shtetnore. Por, më vonë tani ka ndryshu emërtimi i UDB-ashve, tani janë qujtë Inspektora të Sigurimit Shtetnorë.

Njëri ndër ta e mbaj mend sa isha nxanës vinte në shkollë, vinte ni orë, dy orë përpara. Unë e shihja atë, ai nuk më shihte mu se unë isha në mesin e nxanësve e s'ka mujtë me më dallu mu. Ai hynte te referenti i shkollës në zyre tina që të fshihej mos të ekspozohej, mos ta hetonin nxënësit që ka ardhë ni UDB-ash aty. E priste orën e matematikës, në mënyrë të veçantë e priste orën e matematikës së klasës time edhe nga ora më nxirrte prej mësimit, më merrte, më çonte atje në Sekretariat atje, domethënë te organet e punëve të brendshme edhe atje merrte, i zhvillonte hetimet me mua.

Ata e kisha vështirë pak se ishte mosha e re e imja në shkollë të mesme, nxanës i shkollës së mesme. Tash keni parasysh për ni nxanës të shkollës së mesme. Vjen ni përfaqësues i punëve të brendshme i Sigurimit Shtetnor, e hap derën edhe pak kërkua falje gjatë orës së mësimit edhe pa iu drejtue profesoreshës që e kishim aty e shihte se ku jam ulur une ma bënte me gisht, "Dil jashtë!" Ata e përjetoja unë shumë rëndë.

Kam mendu në atë kohë që edhe profesoresha e përjeton rëndë ni nxanës të vetin me e marrë Inspektori i Sigurimit Shtetnor nga ora e mësimit, por nuk kishte qenë e tillë ajo. Ajo kishte qenë më vonë tani morra vesh që pjesëtare e afërme, si duket, nga mbiemri e kam kuptue që kishte qenë e

familjes së Kol Shirokës, ni profesoreshë që nuk e kishte gajle a ia merr dikush nxanësin prej orës së mësimi apo jo.

Nejse, kjo është histori në veti, po megjithatë përjetimet e ndjenjave të mia kanë qenë të tilla. Prandaj edhe e theksova si rast. Jo si emër, se mu nuk më interesojnë emrat. Ka mujtë me qenë në vend të asaj profesoreshë dikush tjetër, sepse ka pasë të tilla nuk ka qenë e vetmja ajo. Edhe pse kemi pasë ndër profesorët edhe kontribues të jashtëzakonshëm edhe në arsim në përgjithësi edhe në aspektin kombëtar që na kanë frymëzu neve. Po ky rast ishte e kundërta, domethonë ni profesoreshë që kishte prejardhje më shumë që ka, që e kanë dashtë megjithatë sistemin jugosllav të asaj kohe edhe pse ka qenë pushtues.

Anita Susuri: A ka ndodhë shpesh që ju kanë marrë kështu në pyetje?

Skender Vardari: Po, po disa herë. Numrin nuk e di po s'paku nga gjashtë-shtatë herë besoj po. Po mu më është dokë interesant që e kom vërtetu edhe vet se ai që ka ardhë me më marrë në pyetje, ai që ka ardhë në shkollë ka ardhë vetëm për mue. Edhe ka mujtë me më marrë edhe në ni orë tjetër, por ai e ka pritë me kah dy orë vetëm të rastis në orën që kisha me të njejtën profesoreshë. Përndryshe nuk hinte nëpër orë të profesorëve të tjerë. Ai e zgjidhte punëtortë, gjegjësisht profesorët, që ishin në dijeni për atë punë por që ishin me ta.

Anita Susuri: E çfarë kanë qenë këto intervista? A ka pasë dhunë fizike a mendore?

Skender Vardari: Po, në atë kohë dhuna nuk ka qenë shumë e theksuar, se kjo osht' e vitit '79. Në '79-tën unë kom përshtypjen, duke u bazu në atë që nuk kom përjetu shumë dhunë të madhe, me përjashtim disa të rreme me shuplaka, pak me shkopinj të gomës që kanë pasë por jo shumë në krahasim me pas '82-shit e knena. Ato kanë qenë, tash kur e bon krahasimin të keqën me të keqën edhe e keqja mes veti dallohet, ka ni gradacion sikurse e mira.

Nga këndvështrimi i sotshëm besoj që '79-ta, megjithatë ka qenë pak ma liberale edhe sjellja edhe e UDB-ashve edhe e policëve në përgjithësi ka qenë pak ma liberal. Ma shumë i kanë besu vetës ni, domethonë ndoshta edhe ka pasë shumë faktorë nashta edhe na kanë nënçmu neve që nuk jemi shumë faktorë ne që të mund të bëjmë diçka. Mund të jetë, domethonë shkaqet mund të jenë nga ma të ndryshmet. Por, me randësi osht' për neve që ne nuk kemi pasë dhunë shumë të madhe, përmasave të mdhaja. Fatmirësisht unë kom pasë kaluar pa u dënue në '79-tën.

Mirëpo, kjo ka zgjatë vetëm deri në '82-tën. E deri te '82-ta i kemi edhe disa përjetime tjera. Po e zjamë me këtë shokun që isha në lidhje në veprimtarinë ilegale me të, ndër të tjerë kishim, kisha edhe shokë tjerë po po flas tash konkretisht për ni shok që kishte lidhje me ni organizatë. Du të kaloj me të kohën e demonstratave të '81-shit, 11 marsin. Me këtë shokun që e kisha shok shumë të afërt shpesh herë ka ardhë te unë, ka bujtë edhe unë te ai.

Duke e përcjellë njani-tjetrit, megjithëse banonim në pjesë të ndryshme të qytetit duke e përcjellë arritim te shpija e njërit apo të tjetrit anasjelltas. Aq shumë nuk ndaheshim, nuk arrimim të ndaheshim për shkak të bisedave, temave që i diskutonim mes veti duke e përcjellë e vazhdonim kur e shihnim vetën që kemi mrrri në shpinë e tjetrit duke e përcjellë. Një ndër të përcjellurit të njëri-tjetrit ka qenë edhe 11 marsi. Kur kemi dalë në qytet nëpërmes qytetit në afërsi të katedralës së sotshme, atëherë ka qenë ni gjimnaz aty në vend të katedralës.

Anita Susuri: “Xhevdet Doda”.

Skender Vardari: “Xhedvet Doda”, po. Po e ndijmë ni zhurmë, parulla tash nuk më kujtohen me cilat parulla e kemi ndëgju zhurmën. Por, u bindëm që osht’ një demonstrim i shumë njerëzve që janë grumbullu dikund edhe parullat neve na e rrënoqethën lëkurën, sepse u befasuam për të mirë. Edhe pse ishim vet aktivë në veprimtarinë ilegale, demonstratat që kanë ndodhë me 11 mars të vitit 1981 neve na gjetën, domethonë u befasum me demonstrata...

Anita Susuri: S’e keni ditë që ka organizim.

Skender Vardari: Nuk e kemi ditë që ka organizim të tillë. Edhe unë isha në atë kohë student i vitit të parë i Shkollës së Lartë Pedagogjike të grupit të BAT-it.² Po meqenëse isha banor i Prishtinës, nuk kam qenë në kontakt as banor i konvikteve që t’kem kontakte me studentët e tjerë që banonin nëpër konvikte. Më vonë tani mas shumë viteve kuptohem që ni pjesë dërmuese e tyne e organizatorëve të asaj nate të 11 marsit të vitit 1981 kishin pasë qenë edhe banor të konvikteve të studentëve.

Kështu që, neve na zuni befasi por me emocione shumë të mëdhaja. Po e përsëris ndoshta edhe një herë, po s’bohet tepër se ato emocione që na kanë përcjellë, e na kanë rrënoqethë lëkurën e përjetoj unë edhe sot e asaj dite. Sepse demonstratat e ‘81-shit kanë bërë ndryshime shumë të mdhaja. Ato që ne me vite jem mundue të veprojmë në ilegalitet, ato që puntortë e arsimit me dekada i kanë kushtue punë e vullnet.

Me vullnet të mirë që ta ngrisin popullatën në ni nivel të duhun, me ni nivel të kulturës edhe të njohurive edhe shumë faktorë tjerë që kanë ndikue në ngritjen e vetëdijes kombëtare demonstratat e ‘81-shit e tejkalun kta krejt. E bonën që ta shtyj procesin në mënyrë të përshpejtume. Krejt kjo na boni me emocione atë natë mu edhe atë shokun. Shkuam ju bashkangjitëm edhe ne demonstratave. Në ballafaqim me policinë atë natë kemi vazhdue deri pak para mëngjesit. Rreth orës, pas 3:00 të natës neve na kanë shpërnda atje.

Anita Susuri: E qysh ka qenë? Çka ka pasë? A ka pasë dhunë prej policisë? A ka pasë gjujtje? Çka ka pasë? A ka pasë rrahje?

² BAT akronim për Bazat e Arsimit Teknik.

Skender Vardari: Po, ka pasë, ka pasë dhunë prej policisë. Nga dhuna e policisë edhe me lotsjellsa ne jemi tërhjekë në oborrin e konvikteve. Në oborrin e konvikteve deri kah 3:00 të natës kemi nejtë. Aty s'na kanë, nuk kanë hy derisa kanë ardhë përforcime edhe ma të mëdhaja. Kur e kanë pa të arsyeshme ata që janë përforcu shumë edhe ne të lodhur pas 3:00 të natës, atëherë kanë ndërhy edhe nëpër oborre. Ne kemi ikë në periferi të konvikteve, në ni lagje në afërsi të konvikteve atje.

Edhe e di që te përmendorja e dëshmorëve, besoj qatë në afërsi të përmendorës së dëshmorëve, në ni shtëpi private e kishte pasë përdhesën e hapur, kështu të pa meremetum aty kemi flejtë nja dy orë, tri derisa e kemi marrë vetën në mëngjes edhe në mëngjes jemi shpërnda nëpër shpija. Kështu e kem pasë përjetimin e parë të demonstratave të vitit '81. Pastaj kam marrë pjesë nëpër të gjitha demonstratat e tjera, domethonë me 26, e me 2 prill e të gjitha kemi marrë pjesë e kemi qenë ktu. Por ato ishin domethonë filli, zanafilla edhe një nismë që nuk do të harrojmë tanë jetën.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ishim duke folë për vitin '81, demonstratat. Na tregutë që keni kalu natën në ni shpi...

Skender Vardari: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj ditët e tjera?

Skender Vardari: Pastaj, rrethanat e asaj kohe, atmosfera e vullnetit edhe dalja në sipërfaqe e mllefit ndaj pushtuesit çdo ditë e ma tepër rritej në përmasa shumë të mdhaja edhe në popull në përgjithësi, po edhe në ne që ishim pjesëtar i popullit shqiptar që ka qenë nën sundimin e Jugosllavisë. Edhe çdo ditë edhe nëpër shpija, në familjet tona edhe në rreth edhe në shkolla vetëm kjo temë bisedohej, vetëm se çka do të bohet nesër. Kështu që, u vazhdunë nën atë inercionin e të bërit diçka që të qitet në shesh që paknaqësia e popullatës nën Jugosllavi... u zhvillunë edhe ngjarje tjera të demonstratave të datave tjera, domethonë.

Në të gjitha kemi marrë pjesë, po tani kem vazhdue në ilegalitet edhe ma të thellë. Pavarësisht që nuk kemi qenë të organizum, por na ka dhanë kurajo shumë të madhe edhe demonstratat e '81-shit. Pastaj kemi vazhdu me aktivitet ma me intenziv duke i shpërnda këto librat ilegale që i kishim. Ka njerëz me vite të tëra kanë marrë dënim vetëm ni libër që iu është zanë, pavarësisht a ka qenë aktiv në ni organizatë, anëtar i ni organizate apo jo. Ai është dënu për ni libër. Bile, bile jo vetëm për ni libër po edhe për ni parollë që ju ka zonë, që ia ka qit' dikush në oborr edhe e ka marrë e ka lexue edhe ju ka zonë, e ka fsheh ai e ka ruajtë edhe ai është dënu për to.

Dënimet kanë qenë drakonike, por ne, aktiviteti jonë ka marrë çdo ditë përmasa ma të shpejta, ma të shpeshta, ma të dendura. Në atë situatë të elektrizume, situatë që e ka çue në ni nivel, në ni stad ma të lartë kto demonstratat na me qat' vullnet kemi punu edhe ma shumë. Deri më, disa ditë para demonstratave të '82-shit kishim tendencë që ta shënojmë edhe përvjetorin në mënyrë që të ju tregojmë pushtuesit se ne do të vazhdojmë me demonstrime, me demonstrata edhe me mënyra tjera paqësore. Vetëm e vetëm ta, t'i tregojmë edhe botës edhe të gjithëve se pozita e shqiptarëve në Jugosllavi nuk është e zgjidhun.

Në këtë kuptim na ka ra në duar, në rrethin e shokve të mi ni trakt i përgatitun nga dikush tjetër, me ni organizatë me gjasë të dikujt tjetër. Po neve, nuk na interesonte organizata, neve na organizonte përmbajtja e traktit. Përmbajtja e traktit ishte që të shënohet edhe niherë demonstratat e '81-shit që të mbahen edhe niherë në '82-tën edhe të thirret populli në demonstrata. Nga përmbajtja e pamë që ajo ishte qëllimi edhe kjo na ka mjaftu neve që të organizohemi ne shoktë, ni rreth i ngushtë i shokve, tre-katër vet që ta marrim përsipër atë trakt, shumëzimin e traktit.

Ne s'kishim njohuri teknike, nuk dinim se qysh mund ta shumëzojmë ni trakt, ni fletë, ni trakt nuk kishim mundësi, nuk dinim edhe metodën teknike si ta shumëzonim ni fletë. Ni shok që kishte njohuri më shumë teknike, ai na mësoi. E kishte konstrukt ai ni shaptilograf në mënyrë mekanike, të thjeshtë, me dorë pa asni automati, automatizëm. Në mënyrë të thjeshtë i kemi shumëzu ato, i kemi përgatitë deri ni ditë përpara. Me 10 mars e kemi pasë planifiku që të dalim, unë vet i dyti, jemi dalë me shpërnda traktet edhe kemi has në polici. Duke u mundu me ju shmang, me ju ikë policisë në ni teposhtëze shumë të madhe të një rrugice të Prishtinës unë kom rrshit, jom rrzue. Ata kanë arritë te une, ai tjetri shoku ka pritë çka me bo. I thom, "Ik ti!" Edhe ai ka arritë që t'i shmang, unë jom nxonë duke i shpërnda traktet edhe jom burgosë.

Anita Susuri: A i keni pasë me veti traktet? Në dorë?

Skender Vardari: Po kemi pasë, kom pasë edhe me veti po edhe të shpërndame.

Anita Susuri: Sa copë, për shembull?

Skender Vardari: Nuk e di. Me copë nuk më kujtohet se ma vonë tani kom kalue edhe nëpër tortura të ndryshme, kështu që ma e humbi kuptimin e sasisë se çka kom pasë, sa kom pasë, qysh kom pasë se fillunë hetimet. Hetimet, ajo domethonë, lidhjet e mija me organizatën në fjalë, a do të zbulohet a nuk do të zbulohet e tjera e tjera. Domethonë, lidhur me sasinë vetëm e di që kem pasë ni sasi të konsiderueshme të mbushur në gjokse kështu me trakte. E nxirrnim një nga një, dy nga dy, kështu. Kurdo varësisht prej pozicionit të shtëpive, aty ku i kemi shpërnda në ato lagje. Edhe aq sa kanë tepu na kanë zanë disa. Une e di që në përfundim e sipër ka qenë, domethonë pjesa ma e vogël e trakteve më është zanë mue. Tjerat i kom pasë të shpërndara, por që fati deshti që të zihem në aksion. Pastaj, ka fillu hetimet e burgu e tjera.

Anita Susuri: Ku ju kanë dërgu fillimisht?

Skender Vardari: Në Burgun e Prishtinës më kanë mbajtur 48 orë, 72 orë faktikisht tri ditë. Ndër torturat tjera fizike që kanë përdorë, kanë përdorë edhe pagjumësinë për shembull te une, nja prej... tani pas, gjatë vuajtjes së dënimit me shokë ku kemi nejt bashkë nëpër qelia të ndryshme, nëpër burgje të ndryshme kom pa që te dikushi nuk kanë përdorë, për shembull metodën e pagjumësisë te une e kanë përdorë...

Anita Susuri: E qysh osht' kjo metoda? S'ju kanë lonë me flejt?

Skender Vardari: Po, s'kanë lanë me flejt. Edhe kur nuk të kanë marrë në pyetje, e kanë kry domethonë bisedën me ty e pytjet që të kanë marrë në pytjen edhe torturën që të kanë bo torturë fizike kanë pauzu ose kanë shku te dikush tjetër ose çfarëdo obligime. Ne nuk kemi ditë se ku kanë shku ata. Po për mu ish ni pauzë disa orëshe. Mrena atyne disa orëve në vend se ta shfrytëzoj për fjetje ose diçka, 72 orë unë s'kom fjet asni minut. S'më kanë lonë me fjet asni minut pas 72 orë torturave fizike edhe ato me roje shtesë. Domethonë, ata kanë shku por e kanë lonë ni polic tjetër që t'runë për mos me fjet. Edhe më kanë thanë që ti s'guxon me fjet, s'ki me fjet edhe ma kanë lonë rojën që të mos flej. Herë m'ka zonë gjumi në tavolinë e s'më ka lonë me flejt roja.

Anita Susuri: Ju ka mshu për me ju çu apo qysh?

Skender Vardari: Po, po. Ato disa herë. Sa herë m'u kanë mbyllë sytë, domethonë prej pagjumësisë kaniherë e durohen edhe sado edhe me të ra se t'zen gjumi.

Anita Susuri: Çfarë pyetje kanë qenë për shembull, me kond bashkëpunoni a?

Skender Vardari: Po, po, po, po. Kryesisht lidhur me aksionin, "Ku e ke marrë? Me kond e ke shumëzu? Me kond ki lidhje?" E tjera, e tjera, të natyrës së tillë. Edhe ka pasë, domethonë hetime njëmbëdhjetë mujshe, njëmbëdhjetë muj kanë zgjatë hetimet. Na kanë qit' në gjyq. Ndërkohë e kanë zbulue që unë kom lidhje edhe me një, me atë organizatën që nuk isha anëtar, po që kisha lexue materiale të ndryshme edhe është zbulu edhe ajo pjesë edhe më është bashkangjitur mue edhe dy shokve tjerë që kemi qenë të organizum lidhur me aksionin që kemi pasë ndërmarrë. Edhe ata i kanë bashkangjitur organizatës në fjalë, sepse ndërkohë kish pas ra [në burg] edhe organizata. Na kanë qit' në gjyq bashkë me ta...

Anita Susuri: Kjo organizata që thatë marksiste diçka...

Skender Vardari: Po, Partia Komuniste, Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi. Me kta jam dënu bashkë. Aktakuzën e kam pasë të ndarë nga organizata. Organizata e ka pasë aktakuzën e

veçantë të tyne. Ne të tre, ne tre ishim domethonë që jemi merr me shpërndarjen edhe shumëzimin edhe shpërndarjen e traktit. Ne të tre e kishim aktakuzën e veçantë, mirëpo aktgjykimin e kemi pasë të përbashkët sepse na dënujë s'bashku. Me dy prokurorë, prokurori ynë i tre anëtarëve, i tre vetëve edhe prokurori i atyne 20 e kusur vetëve që kanë qenë të organizatës. Kanë qenë dy prokurorë, dy aktakuza, një aktgjykim. Kështu që, na dënujë e ndër të tjerë, domethonë mu m'kanë dënuë tetë vjet burg në atë kohë.

Anita Susuri: E kto njëmbëdhjetë muj që thatë, ku keni qenë?

Skender Vardari: Në Burgun hetues të Prishtinës.

Anita Susuri: Në Prishtinë.

Skender Vardari: Po, po, të Prishtinës.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë kushtet në këtë burg?

Skender Vardari: Në Burgun hetues të Prishtinës si shumë burgje të Kosovës kushtet kanë qenë mizerje, domethonë dhomat e vogla. Ai burgu është në formë të urës pothuajse në formë të rrethit.

Anita Susuri: Gjysëm hanë.

Skender Vardari: Si gjysëm hanë. Dhomat kanë qenë përbrenda harkut. Koridori në anën e jashtme të harkut, jo koridori jashtë po domethonë në anën e jashtme është me rëndësi, sepse dhomat kur janë të brendshme dalin në formë të konit edhe të vogla edhe në formë të konit. Rreth ni metër e diçka më duket, përafërsisht njanën anë. Në anën tjetër dy metra e diçka mund të jetë pjesa tjetër për shkak të pozitës së dhomës që është në formë të konit. Në dhoma të vogla, kryesisht me nga katër-pesë deri në gjashtë edhe shtatë veta me një dhomë. Sikur sardinat e peshqëve që janë kështu. Nuk kishim vend ku ta kthejmë krahun për fjetje. Deri edhe mjetet për pastrim për nevojë i kishim brenda dhomës.

Gjithçka të paramendume që ta degjenerojnë, gjithçka që është e mundur me karakterin e njeriut ishte e parapame qysh herët prej tyne. Në rast se bjen dikush në burg të ta prekin në karakter njeriun edhe me mjete. Përveç që kanë përdorë, domethonë mjete të dhunës, mjete të ndryshme të dhunës po edhe ambientet i kanë pasë të tilla që të ketë ndikim në vujtjen e njerëzve. Kështu e kemi...

Anita Susuri: Qysh ka qenë ushqimi? A ju kanë sjellë aty?

Skender Vardari: Po. Ushqimi ka qenë jashtëzakonisht i dobët. Une gjatë hetimeve, gjatë hetuesisë kemi pasë të drejtë, hetuesisë i kemi qujtë deri në shqiptimin e dënimit në gjygj, sepse hetuesia e ka

pasë ni fazë disa muajshe. Pasi na kanë shqiptu dënimin na përsëri kemi qenë në të njejtat burgje për ni kohë, për disa muj. Pas disa mujve na kanë ndrru burgun, për shembull kemi shku në ni burg tjetër.

Unë, për shembull, konkretisht kom shku edhe në Mitrovicë, por edhe Mitrovica kushtet e burgut kanë qenë njësoj. Burgu përsëri ashtu në formë të rrethit komplet, tamon rreth edhe dhomat qashtu të vogla. Mirëpo edhe ai ka qenë burg hetues. Edhe pse ne e kemi pasë krye hetuesinë. Domethonë, kemi qenë të burgosur të dënumë që osht' dashtë me na bartë diku ku do të vuhet, me majtë dënimin. Po na kemi vazhdue, neve na kanë majtë nëpër burgje hetuese me vite të tëra.

Anita Susuri: E pse ka ndodhë kjo?

Skender Vardari: Kjo ka ndodhë, nuk kemi shumë siguri por e dijmë që kudo që kemi shkue burgjet kanë qenë përplot. Edhe besoj që një ndër faktorët ka qenë edhe ajo që nuk ka pasë vend. Ata kanë majt nëpër burgje plot.

Anita Susuri: Gjatë kësaj kohe që keni qenë në Prishtinë në burg, a ka pasë vizita a qysh ka qenë ni ditë e zakonshme?

Skender Vardari: Po. Me përjashtim të ditëve të para, ditëve të para zakonisht ju kanë shmang. Ditëve të para kanë qenë hetimet intenzive, dhuna intenzive, dhuna e teprume, me pasoja të, që shihet edhe nëpër trup edhe aty ju kanë shmang aty ktu për të mos t'ju dhonë të drejtë të burgosurit me pasë të drejtë vizite familjarëve. Tani gradualisht kem fillu që t'i kemi vizitat e familjes çdo 15 ditë sa ishim ktu në Kosovë.

Pastaj nëpër burgjet tjera kanë ndryshue, në mujt niherë kem pasë vizitë. Po ktu çdo 15 ditë. Unë nuk e mbaj në mend ni vizitë që ka zgjatë pesë minuta, shumica e vizitave të mija kanë zgjatë më pak se pesë minuta. Edhe pse s'kem pasë të drejtë ore me marrë, por përafërsisht kem mendu që ma shumë se dy-tre minuta s'kem pasë vizita. Vetëm sa për me i pa, me na pa familja edhe na me i pa ata.

Me do grila që në kuadër të ktyne intervistave të juve ju kisha sugjeru që ta vizitoni Burgun e Prishtinës edhe ta shihni atë ambientin e vizitorëve. Familja ni të afërm të vetin sa mundet me e pa përmes atyne grilave. Aq shumë janë të vogla vrimat e grilave, veç sa munësh me identifiku që e ke të afërm, tan djal, motër, vlla çka e ke, veç munësh me pa që osht' ai ose ajo. Po detajet tjera ka qenë e pamundur me pa përmes atyne birave. Shumë të vogla.

Anita Susuri: Kush ju ka ardhë juve në vizitë?

Skender Vardari: Atëherë i kom pasë une prindtë e mi gjallë, motrat që i kom pasë ktu sepse ka mbetë nashta e pa shpjegueshme deri në fund ni storie e vogël e familjes time. Kur jemi kthy ne në Kosovë, mu më kanë mbetë dy motra të martume atje në Stamboll. Ndërkohë më është martu edhe ni motër

ma e vogël se une se une atje në Stamboll. Kështu që, unë i kom pasë tri motra atje. Ato dy motra sa isha në vujtje të dënimit i kisha atje, ato dy motra shumë vjet nuk e kanë ditë që unë jam në burg. E kanë majtë në fshehtësi kta prindtë e mi të familjes teme për mos me u mërzit motrat atje në Turqi.

Që do me thanë ktu, në vizitë më kanë ardhë prindërit edhe dy motrat edhe tri motrat që kanë jetu ktu niherë. Ma vonë tani njana motër është martu atje. Pastaj, kemi kalue në, mu më kanë transferu në Burgun e Mitrovicës. Edhe në Mitrovicë kushtet e njejta. Pas Mitrovicës mu më kanë transferue në Burgun e Prokuples. Tani në Burgun e Prokuples kemi pasë sfida të mdhaja. Derisa ktu në kushte të vështira edhe të ambientit të burgut edhe të qelive edhe të higjienës e tjera. Kishim probleme shumë të mdhaja, domethonë mundësitë ishin shumë të vogla në kushte të vështira.

Atje tani na u vështirësue edhe në aspekte tjera vujtja e dënimit. Ktu në kto rrethana s'paku familjeve tona na i lejonin që të na sjellnin libra, literaturë të ndryshme. Atje e kemi pasë të ndalume literaturën në gjuhën shqipe me lexu, merre me mend, në të njejtin shtet. Në Prokuple nuk kem pasë mundësi me lexue literaturë në gjuhën shqipe, s'na kanë leju. I kanë refuzu disa herë edhe nuk kem marrë. Atëherë fillumë të lexojmë edhe serbisht.

Kështu që, unë kur jam kthy në Kosovë si fmi nuk e kam ditë shqipen, i ra që e mësova gjuhën time amëtare në Kosovë. Tani në burg fillova me mësu edhe serbo-kroatishten, gjegjësisht serbishten. Serbo-kroatisht i kemi thanë, po serbisht ka qenë ajo. Gjuhën serbe e kom mësue në Prokuple, duke u lexu që të lexojmë megjithatë literaturë atë që e gjenim në bibliotekën e burgut. Edhe burgu e kishte ni bibliotekë të vetën, e shfrytëzunëm atë. Në pamundësi që të lexojmë në gjuhën shqipe.

Anita Susuri: E me personat që keni qenë, për shembull në qeli ose në burg a kanë qenë shqiptarë edhe ata? A kanë qenë me të njejtën aktakuzë? Po mendoj dënim.

Skender Vardari: Për shkak të numrit të madh të të burgosurve politikë shqiptarë nëpër të gjitha burgjet e Jugosllavisë, ne kemi pasë kontakte në periudhat kohore të ndryshme. Kem pasë kontakte me të burgosur politikë shqiptarë mes veti që nuk jemi njoftë përpara. Dikush ka qenë i dënum me ni organizatë tjetër, dikush me ni tjetër. Tani na ka bashku burgu edhe pse s'jemi njoftë përpara. Mirëpo, krahas tyne, ne kemi vujtë burgun gjithmonë me të burgosur ordinerë.

Me të burgosur ordinerë jo vetëm shqiptarë po edhe serbë e malazezë. Edhe ata kanë qenë nëpër burgje s'bashku me ne, domethonë në të njejtat ambiente. Ku ishim ne ishin edhe ata. I kanë kushtu rëndësi që të jemi bashkë me ta. Me qëllim i kanë kushtu rëndësi që të jemi bashkë me ta, sepse kohë pas kohe kanë lindë edhe konflikte të ndryshme, i kanë përdorë për spihunim gjatë vujtjes së dënimit...

Anita Susuri: E të burgosur ordinerë, domethonë hajna, vrasës?

Skender Vardari: Po, po, të gjitha. Vrasës e dhunues e hajna, gjithçka. Edhe zakonisht ata kanë qenë të burgosur serbë e malazezë, por edhe ktu kemi pasë por ktu kemi pasë më pak. Ktu kemi qenë të koncentrum më shumë të burgosur politikë në Prishtinë edhe në Mitrovicë. Gjegjësisht nëpër burgje të Kosovës ma së shumti ka pasë të burgosur politikë.

Anita Susuri: Dashta me ju pytë edhe kur kanë ndodhë kto transferimet prej burgut në burg a ju kanë paralajmëru? A keni pasë naj lloj...

Skender Vardari: Jo, asni paralajmërim, asniherë të vetme nuk kemi pasë. Vetëm momentin e fundit e hap derën e qelisë, filan fisteku bonu gati edhe të pret për pesë minuta, se s'ki çka bon gati krejt i ki me ni kесе të vogël se nuk ke mundësi ma shumë tesha me majt me veti. Vetëm duhet m'i ndrru përmes vizitave të familjes se edhe ambienti edhe vend nuk kemi pasë nëpër qelia që të majmë tesha rezervë shumë, po gjithmonë nga pak, aq sa na u ka dhanë mundësia. Edhe të paparalajmërum jemi transferue çdo herë, sa herë jemi tranferu prej burgut në burg tjetër.

Nën masat e sigurisë shumë të mdhaja, të lidhun me ato, me zingjirë edhe i burgosun me të burgosur. Përveç me vetvetën që të lidhë dy durte, po të lidh edhe me ni të burgosur tjetër që ta kufizon edhe më tepër lëvizjen edhe mundësinë, mundësitë e tjera. Kto i kanë përdorë vazhdimisht. Na u kanë bo rutinë ato, na u kanë dokë sikur me qenë normale. Kur të kalon me vite të tana nëpër burgje edhe ni transfer i tillë të doket sikur është normale.

Anita Susuri: Po më intereson dhuna që ka qenë, në fillim thatë që ka qenë shumë ma intenzive po a ka vazhdu edhe gjatë gjithë burgimit? Për shembull, atje në Prokuple.

Skender Vardari: Po, ka vazhdue në mënyrë sporodike ka vazhdue, sepse kudo që kemi shkue kanë qenë do rregullore, brenda ambientit të burgut që duhet t'i nënshtrohemi të burgosurit. Kur vjen, kur hapet dera vjen mbikqyrësi ti je i detyrum që të rreshtohesh në ni burg tjetër. Në ni burg ktu nëpër Prishtinë, për shembull, sa je i ulun duhet të ngritesh në kambë edhe me nejt gaditu. Në burgun tjetër rreshtohesh për ni, sikur ushtar gjithashtu në formën gaditu.

Në ni burg tjetër kur e nin çelsat e dyrve të qelisë duke u hapë ti je i detyrum që t'ja kthesh shpinën, të jesh i gaditun edhe të ja kthesh shpinën komplet, të mos e shish kush po hyn brenda edhe të jesh i gaditun. Ai e ka shpinën tane e sheh, ti duhesh me qenë i gaditun edhe duke iu përgjigje pyetjeve që e parashohin kush je, prezantimin tond me e bo gjithqysh. Jo në sy drejtpërdrejt, po duke ia kthy shpinën. Këto rregullore të ngjashme kanë ndryshu nga burgu në burg.

Tani ka pasë, për ta rëndue jetën në burg, kanë marrë edhe veprime të ndryshme me vetmia, dënimet me vetmi domethonë. Për hiçgjë kanë dënu njerëzit që t'i çojnë në vetmi. Përveç që atyne nëpër qelia ku ishim me nga tre-katër vetë, kanë dënu nganjëherë edhe me vetmia. Unë nuk e di në totale mund të kem rreth tre muj e diçka vetmi. Po nuk e di saktë se në mënyrë sporadike shkojnë ato edhe nuk i kemi

evidentue. Sepse ne kur kemi hy në burg unë për veti kam qenë nën ni psikologji që pak a osht' e mundur që të mundët njeriu me dalë prej burgut gjallë. Që gjasat ma të mdhaja janë që të mbetemi të vdekur në burg. Sikur nuk e dini, mosvet!

Por të dalim pas gjashtë vjet, të përjetojmë atë vujtje të burgut edhe pas gjashtë viteve të dal une, nuk e kom paramendu asniherë, asniherë nuk e kam paramendu. Me këtë logjikë edhe nuk kem bo numërime sa kem nejt në vetmi, sa kem nejt me tjetër. Ka shumëçka që nuk [më kujtohet]... takohem unë, tani pas luftës, për shembull me disa shokë që kem qenë në vujtje të dënimit bashkë. Ai tregon ni përjetim tonin të përbashkët që e kishim përjetu edhe unë edhe ai, që mu më dukej sikur nuk m'ka ndodhë mue, nuk e kom përjetu une po ai me dikë tjetër. E kam harrue atë storie qat' përjetim që e kom bo me të e kom harrue. Ni storie tjetër që unë ia shpjegoja atij i dukej që nuk e ka përjetu ky. Domethonë, nuk e kemi shumë të memorizume gjithçka çka kem përjetue.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Ju sa keni qenë në Prokuplë, a keni pasë edhe aty vizita?

Skender Vardari: Po, aty kemi pasë vizitë...

Anita Susuri: Niherë në mujt që thatë.

Skender Vardari: Me gjasë, niherë në mujt ka qenë edhe në Prokuplë, niherë në mujt më duket. Po, po, niherë në mujt. Nuk jom shumë i sigurt në Prokuplë a ka qenë 15 ditë apo niherë në mujt. Në Nishë ka qenë niherë në mujt. E kështu që është periudha e fundit e vujtjes së dënimit tim në Nishë. E më ka mbetë në kujtesë që duhet të jetë niherë në mujt. E ktu jom i sigurt që në Prishtinë edhe në Mitrovicë ka qenë në 15 ditë ni herë.

Anita Susuri: A ju kujtohet sa vite keni qenë në Nishë?

Skender Vardari: Në Nishë kemi qenë, unë për veti disa mujt e fundit, tetë muj apo nëntë nuk jom shumë i sigurt. Përafërsisht, rreth tetë-nantë mujve. Ktu disa muj derisa më kanë mbetë gjashtë muj më kanë mbajtë në izolim. Ishte ni repart i veçantë i izolimit. Atje edhe... atëherë kemi pasë shku ne në Nishë derisa na i morën shënimet, i morën informatat për neve. Se përcilleshe, çdo i burgosur që transferohej prej burgut në ni burg tjetër edhe dokumentet. Më vonë morëm vesh që edhe dokumentet shkonin në përcjellje të të burgosurve. Kështu që, ato procedura derisa i kem përjetue kanë kalu disa, nja dy muj, tre.

Në gjashtë mujt e fundit edhe më kanë vendosë në ni repart tjetër, domethonë jashtë izolimit gjashtë mujt e fundit të vujtjes së dënimit. Por, paraprakisht duhet t'i kthehem edhe njëherë Prokuplës. Në

Prokuple kemi pasë sfida edhe të tjera. Në... duke u mbështetë në rrethana të tilla çfare i kishim ne aty, gjatë vujtjes së dënimit dikur na u bë e padurueshme, sepse bënim kërkesa të kohë pas kohshme, njerëzve kompetent përgjegjës të asaj kohe të atij burgu që të na lejonin literaturën, që të na lejonin kushte tjera. Shëtitjen ta kishim ma të gjatë, domethonë për shkak të shëndetit, për ta rujtë shëndetin e kishim nevojë për shëtitje ma të gjata, lëvizje ma të gjata.

Anita Susuri: Sa keni pasë shëtitje?

Skender Vardari: Edhe shëtitje që osht' mvarë krejt prej atyne gardianëve. Prej pesë minuta deri në dhetë minuta. Kanë qenë shumë lëvizje të kufizume të shëtitjes. Mbas shumë kërkesave tona që s'na lejonin literaturën edhe kushtet tjera na hynëm në grevë të urisë. Edhe u morëm vesh të gjithë të burgosurit politikë që ishim në burgun e Prokuples, edhe pse të ndarë nëpër qelia të ndryshme edhe në ato kushte gjenim mënyrën, metodën se qysh të komunikojmë mes veti. Me letra të fshehura nëpër oxhaqe nëpër kah mos. Edhe u organizum brenda për brenda burgut që të hyjmë në grevë. Hynëm në grevë urie.

Pas disa ditësh, nuk e di cilën ditë saktë se kur po fillon greva e urisë edhe pak a shumë po zbehet ajo logjika e shëndoshë e jetës, po zbehet të menduarit nuk është shumë, nuk ka shumë kjetësi. Se kam përjetu, une për veti, dikush edhe ma shumë, po une njëmbëdhjetë ditë s'kemi marrë ushqim hiç.

Anita Susuri: Njëmbëdhjetë ditë!

Skender Vardari: Po. Me gjasë ditën e dhetë apo të nëntë, nuk më kujtohet, po ni ditë para se t'na transferonin përkohësisht prej Prokuples, na morën në kontrollë të mjekut. Se çrregullimet veç fillunë pas ditës së tretë, të katërt te secili, varësisht prej organizmit qysh e kishte organizmin. Fillunë çrregullimet nga pasojat e grevës së urisë. Na kontrollunë. Mua më shtrijnë në ni tavolinë kështu edhe më lidhen duar e këmbë që të më japin ushqim artificial për shkak të gjendjes shëndetësore që nuk e kisha mirë. Ai mjeku tash filloi me mi lyp damartë e duarve, nuk i gjente. Damartë nuk shiheshin, shumë të holla. Edhe e pa, i thotë gardianit vetëm me gjeste, që nuk po ia gjej dot damartë qysh me ia dhonë ushqimin artificial. Unë e kuptova pa folë ai që... nga gjestet.

Edhe qaq shumë ishim të bindun që ose do të na mundësojnë kushtet që i kishim parashtrur drejtorisë së burgut ose do të vdesim. Edhe i thom mjekut me gjithë ni gardian ish, te dytë bashkë, i thom, "Ne shqiptartë kur nuk dojmë me marrë ushqim as damartë nuk na pranojnë", kta ia kom thanë. Me plot bindje kom thanë që, a kishte me shpëtu se nuk kisha shumë siguri që muj me kontrollu organizmin tim që t'mos e merr as ushqimin artificial. Por, megjithatë, bindjen e kisha të tillë që kur nuk du une s'keni me mujtë me më dhanë as në mënyrë artificiale. Nejse ma veç më kthyn në qeli.

Të nesërmen me gjasë, na e hoqën mua edhe nja tre-katër veta tjerë, na bonën bashkë. Na hoqën prej burgut të Prokuples. Na çunë në burgun e Nishit. Mirëpo, pjesa tjetër e shokëve që kishim fillu bashkë

grevën ata i lam aty. Ata vazhdonin grevën. Neve na hoqën ni pjesë, ni numër shokësh me qëllim që të na thenin. Sepse na në mes vete ishim marrë vesh, kudo që të na çojnë diku tjetër, çfarëdo kushte që t'janë diku tjetër se nuk e kishim idenë na çfarë kushte ka në burgje tjera. Na e dinim nëpër ato burgje ku kemi vujt dënimin deri aty, e diku tjetër nuk kishim informata, sepse ishim shumë të izoluar.

U morëm vesh që kur të na heqin prej ktuhit, na transferojnë nga burgu i Prokuples, na transferojnë kudo që të na çojnë e marrim ushqimin. Edhe na e morëm ushqimin atje, mirëpo edhe atje kem pasë sfida në Nishë. S'po i kthehem niherë, vetëm te Prokupla se ata që i lam aty, i lam në grevë ata vazhduan grevën. Neve na çuan në Nishë.

Në Nishë mas njëmbëdhjetë ditëve të grevës na rrahën, ajo ishte metodë e tyre e mirëseardhjes së të burgosurve. Ni lloj shpalirje. Termin shpalir unë nuk e kisha dëgjue n'atë kohë. Shpaliri ishte metodë e aplikimit të dhunës që është emërtu me emrin shpalir qysh herët, meniherë mas Luftës së Dytë Botërore kur osht' formu Jugosllavia e kishte përdorë këtë metodë shpalir, po unë nuk e kam ditë. Unë e mësova me (qeshë), kur më takoj që t'i nënshtrohem shpalirit atëherë e mësova se çka osht' shpaliri...

Anita Susuri: Domethonë qajo mirëseardhja me rrahje osht' shpalir.

Skender Vardari: Po, mirëseardhja me rrahje në një koridor mundësisht, në të dy anët me kordon të gardianëve ti ki me kalue në mes tyre, ata duke të rrah ty me shkopinje e me çka të kenë në dorë e me shqelma derisa ta kalojsh ti atje. Nëse bjen, ata të presin derisa ti të çohesh. Nëse je mirë edhe për s'راتi të bijnë derisa te kalojsh aty. Kjo u kanë...

Anita Susuri: E ata që e vazhdunë në Prokuple grevën, a e dini çka kanë bo?

Skender Vardari: Po, pas ditës së tremdhetë ata veç masi na kthynë i morëm informatat. Se neve na kthynë mas tri ditëve na kthynë prej Nishës. Si e morëm bukën, tri ditë nejtëm aty edhe na rrahën edhe na kthynë në burgun e Prokuples përsëri. Kur shkum në burgun e Prokuples, shokët që kishin pasë mbetë aty, kishin vendosë që ta marrin ushqimin. Se mas ditës së njëmbëdhjetë, dymdhetë, tremdhetë, ma nuk ka siguri të jetës, siguria e jetës bjen në minimum. Veç mujnë me u paraqitë vdekjet njëpasnjëshme pas ditës së njëmbëdhjetë, dymdhetë, tremdhetë.

Ka dikush që ka mujtë me majt me kah 20-27 ditë, janë të njoftuna. Po tani për momentin s'më kujtohet disa revolucionarë ndërkombëtar që i kemi njoftë me emra, i kemi ditë që rreth 27-28 ditëve kanë, nuk kanë marrë ushqimin edhe i kanë shpëtë. Dikush pas 30 ditëve kanë vdekë. Kur u kthym e kishin pasë marrë ushqimin, ne u gzumë që e kanë marrë ata ushqimin. Për shkak se na dhimbeshin, sepse i kishim shokë që, edhe shokë edhe bashkëvujtës edhe të idealit domethonë.

Por, nuk shkoi gjatë, domethonë qajo grevë e boni të mundur që neve të na transferojnë komplet prej burgut të Nishit, ksi burgut të Prokuples që të na transferojnë në burgun e Nishit. E në burgun e Nishit

gjashtë mujt e fundit i kom pasë kushtet ma të mira. Nga gjashtë vite burg, gjashtë mujt e fundit e kanë pa të arsyeshme që për gjashtë muj ky nuk ikë, nuk paraqet farë problemi edhe mujnë me e qit' te të lirtë, për ta lirue me gjasë. Po supozoj une, se nuk kom informata kështu, po po supozoj që t'mos jem në mesin e të tjerëve atje ku e vujnë dënimin që kanë hala shumë vite.

Qato gjashtë mujt e fundit e kam kalue në rrethana fizike ma të mira. Sepse ai pavion, ai sektor ku ishim ne ishin për të gjithë, domethonë edhe për të burgosur serbë edhe për shqiptarë. Por që nuk kanë dënime shumë, kanë më pak dënime. Kurse kta tjetër kanë qenë në kushte ma të kufizume ku isha edhe unë përpara. Kështu do ta kisha përfundue i bindun që kam shumë përjetime, por nuk mund t'i themi ndoshta me ditë, ndoshta edhe me muj të tëra nuk muj m'i thanë të gjitha. Vujtja e burgut qishte ka përfundu.

Kom dalë prej Burgut të Nishit, përsëri siç ka thanë baca Adem, "Në burgun e madh të Kosovës". Kem vazhdue jetën gjithnji krejt kjo periodë është për familjen time si shtetas të huj. Kom harru me theksue në fillim, qysh na fillimi, se na gjatë tërë kësaj kohe ne kem jetu në Jugosllavi si shtetas turk. Edhe pse kemi pasë bo kërkesën që ta marrim shtetësinë jugosllave nuk na është mundësu, na është refuzu, por edhe nuk na kanë përzanë njëherë, na kanë majt qashtu.

Po kur kom dalë prej burgu... prej burgu kom dalë në '88-ën. Në '93-tën, se unë pas burgut kom pasë fillu me punue në pazar, domethonë në tregun e fruta, perimeve të Prishtinës, sepse babai im ka pasë punu atë punë edhe dola t'i ndihmoj atij. Nga tregu më kanë marrë në '93-tën, atëherë ishte, ishin të njohura bisedat informative i thonin në atë kohë. Veprimtarë të ndryshëm për çashtje të ndryshme, për arsye të ndryshme që ata i dijnë vet për çka na kanë marrë, na merrnin në biseda informative. Gjithashtu ajo osht', domethonë, sikur hetimet që i kemi pasë para dënimin. Aty fillunë hetimet, "Çka po bon? Çka po punon? Me kond po kontakton? Kush janë shoktë? Me kënd po... a po vepron? Nëse po vepron, me kënd po vepron e tjera, e tjera." Ngjashme me kto pyetje nga më të ndryshmet.

Unë duke u mbrojtë në atë që, "Unë jam njeri që kom qenë kundër Jugosllavisë, kom vujtë dënimin. Tash nuk po veproj, po e kqyri punën teme. Po punoj, po gjallnoj për familjen teme, asgjë tjetër". Po kto zgjatën disa muaj se më thanë, "Mirë, sot shko. Eja javën tjetër të hanën". Kur më morën në pyetje të hanën tjetër më mbanin me nga ni orë, dy pastaj më thanë, "Hajde mas dhetë dite në këtë datë". Shkoja përsëri, përsëri më thonin, "Hajde javën tjetër, hajde mas dhetë dite, hajde mas dymdhetë dite". Kështu që, filloi të, fillova ta marr atë si presion psikik edhe më rritej frika, se kta e kanë synue që të më depërtojnë, të më përzojnë prej Kosove si shtetas të huj. Mirëpo, nuk ma thonin në fillim.

Dikur kërkonin bashkëpunim, bashkëpunëtor, të jem bashkëpunëtor i tyne, "Masi ti s'po vepron", domethonë, s'je kundër shtetit, "nuk po vepron, s'je kundër shtetit. Atëherëm eja me neve mos rri atje". Po une u mundohesha ta luaj një politikë 'ngrehe mos e kput' duke mos dashur që të vijë deri te përfundimi i asaj që frikohesha une, që do të më përzojnë prej ktuhit. Po kur e pashë në pamundësi vendosa thashë, "Shife, kjo", thashë, "osht' hera e fundit që më thirrni ju. Ju muni me më thirrë apet,

po unë nuk do t'vi ma. Ju muni me më marrë me dhunë, po me vullnet timin ma nuk do të vi te ju”, “Pse? Çka po të pengoj kjo biseda me neve?” “Po, po më pengon se ju po ofroni bashkëpunim me juve. Ju duhet ta dini që unë deri tash jom deklarue që unë nuk po veproj asgja kundër Jugosllavisë prej që kom dalë prej burgut, por kjo nuk e ka domethanjen që unë jam bashkëpunëtor i juji. Ju duhet ta dini që une me juve jemi në tabore të kundërta, pavarësisht asaj që a veproj unë konkretisht a jo. Unë konkretisht nuk po veproj, por jemi në tabore të kundërta”.

Kur ia kam thanë këtë tha, “Deri tash nuk u dashtë me na hupë kohë neve”, tha, “shumë mirë që po je kaq i singertë. Tash”, thotë, “prit ktu”. Më la aty në zyre nja pesë minuta. Dul jashtë. Erdhën dy policë më lidhën më dërguan deri te ni femër gjykatëse, gjithashtu shqiptare. Kjo ‘93-shin. Ajo më dënoi dhetë ditë burg me arsyetimin që jam shtetar i huaj, po jetoj në Jugosllavi pa i informu organet gjegjëse. Një arsye banale. Më çunë përsëri në burgun e Prishtinës në pjesën e kundërvajtësve, sepse në atë kohë ishte, burgu i Prishtinës ishte... E kishte pjesën edhe të kundërvajtësve veç, ata që ishin në hetuesi veç.

Aty nejta dhetë ditë. Pas dhetë dite kur erdhi koha që të më lirojnë prej dënimit, ata nuk më lirunë paradite edhe e dita që si u bo dreka ata do të ndërmarrin ndonjë masë tjetër. Masa tjetër që gjithnji unë e kam pasë si “shpatë të Demokliut” që m’ka nejt mi kokë, se e disha që jam shtetar i huaj ni ditë do të më depërtojnë. Edhe u bo qajo ditë. Mas dhetë dite të vujtjes të burgut më lidhën përsëri. E kishin informu familjen time që, domethonë, gjegjësisht babain tim që djaln do ta depërtojmë për Turqi.

Babai nga frika që do të më vrasin rrugës i drejtohet bashkëshortes sime. Ndërkohë, bashkëshorja ime e ka pasë, domethonë e kem pasë ni djalë edhe ni çikë. Thotë, Fetije e ka pasë emrin, e ka emrin domthonë. Thotë, “Fetije, a guxon bre çika jeme me i marrë fmitë edhe me ju bashkangjitë Skenderit e me shku bashkë për Turki, qat’ rrugëtim e boni bashkë anena?” Kjo thotë, “Po, po” thotë, “unë do të shkoj. Çkado që të na ndodhë, le të na ndodhë bashkë”. Edhe ata me frikë që do të më eliminojnë diku rrugës. Po m’u bashkangjitet bashkëshorja me gjithë dy fmi.

Rrugës e sipër dy UDB-ashë serbë, duke bisedu edhe ata mes veti edhe me mue, duke më thanë, “Qysh po të doken kto male?” Se ishte rruga Prishtinë - Nishë edhe me m’qitë në drejtim të Bullgarisë, në dalje të Bullgarisë, deri në Dimitrovgrad më duket. “Po kqyri mirë kto male”, thojke, “po nuk osht’ shumë larg edhe e kemi ni vend ma të përshtatshëm që nuk e din kërkush. Edhe mirë ke bo që e ke marrë bashkëshorten me veti edhe fmitë”, po kta serbishten nuk e dinin, “edhe të likfidojmë bashkë”. Nën qët’ presion, nën qëto kërcënime deri në kufi më kanë çu.

Unë nuk e kam përjashtu që është e mundur me më likfidu aty me gjithë familje. Por, frikë kom pasë shumë, sepse ishte e pa... isha i paparalajmrum që do të më bashkangjitet bashkëshortja me gjithë fmi. Edhe isha me mendime që qysh u bo që bashkëshortja të vjen me mue, pse? Nuk mujsha me pytë nërsy tyne, se kumeditë çfarë përgjegje mund ta merrja që s’kisha, ndoshta nuk do të kisha pasë

dëshirë që ta ndëgjojnë kta, domethonë, UDB-ashët që i kisha me veti. E më transferunë atje në Turqi. Deri në Turqi jo, deri në kufi.

Me kto dilema, me këtë presion, me këtë frikë, frikë haptas po e thom pa hezitim, sepse me të vërtetë kom pasë frikë. Edhe njeriu kishte frikë kur ka përgjegjësi për jetën e fmive edhe të bashkëshortes. Në kto rrethana më kanë qit' jashtë. Tani në pjesën e Bullgarisë kemi pritë disa orë në autobus udhëtarësh që e kishte drejtimin për Stamboll edhe na mori ai i autobusit. S'kishim as para për biletë. Na ka marrë pa para na ka çue në Stamboll. Atje te motrat kom shkue edhe kom vazhdue jetën në Turqi prej '93-tës deri pas luftës.

Gjitashtu në izolim mund të them lirisht total edhe atje, sepse edhe atje para luftës Turqia, nga shteti turk nuk e kemi pasë përkrahjen e duhur. Vonë dikur, kur filloi lufta në Kosovë atëherë shteti turk mori qëndrim liberal. Tani mori qëndrimin në anën tonë, njëherë liberal pastaj në anën tonë. Pastaj edhe na ka ndihmue. Gjatë asaj kohe si i huj tani përsëri në Turqi. Aty ku isha i lindur isha i huj, sepse si fmi jom rritë ktu, jom formu ktu. Edhe nga një fmi turk, tani i formun me ni karakter që ka identitet kombëtar shqiptar e që për veti identiteti turk është i huj. Me ni qëndrim të tillë kom shku në Turqi, më kanë përzanë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë qysh jeni ndje në atë moment kur e keni kalu kufinin edhe kur e keni kuptu që keni pshtu?

Skender Vardari: Kufinin faktikisht unë e kom përjetue shumë rondë, domethonë depërtimin e kom përjetu shumë rondë. E kom përjetu shumë rondë, sepse këtë frikë e kom pasë edhe ma herët. Aq shumë kemi qenë të pregatitun të formun, unë për veti, saqë nuk kom mujtë me paramendu ni jetë jashtë Kosovës. Mu më ka lidhë edhe veprimtaria edhe bindja e një uni shqiptar që kom mujtë me i thanë vetës, pavarësisht prej rrethanave që kemi jetu ktu. E jetën jashtë nuk kom mujtë me paramendu.

Edhe kur më kanë qitë e kom përjetu ma rondë sesa burgun, psiqikisht e kom përjetu shumë ma rondë. Jo si një ndjenjë të shpëtimit tim, shpëtimit prej vdekjes a diçka ashtu nuk e kom përjetue. Është e vërtetë që kom pasë ni gzim për fmi, për bashkëshorten që kanë shpëtu ata. Po vetën nuk e kom konsideru që kom shpëtue pse m'kanë qitë ata jashtë, vetën e kom konsiderue përkundrazi ma të dënum sesa dënimet që i kom vujt në burg edhe këtë me plot sinqeritet po e thom.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Deshta me u kthy, se në fillim kur tregut për burgun thatë që jeni dënu tetë vite po keni majtë gjashtë.

Skender Vardari: Po.

Anita Susuri: Ju kanë ulë dënimin apo si?

Skender Vardari: Po, shkalla e parë më ka dënu tetë vjet me të drejtë ankese, domethonë secili që është dënu ka pasë të drejtë ta bëjë një ankese. Por, unë nuk e kam përdorë as të drejtën e ankesës, nuk kam bërë ankese me shkrim, as me gojë, as me shkrim asnjëherë. Ma vonë tani e kom kuptue që është ni e drejtë juridike, megjithatë në mesin e atyre padrejtësive të mdhaja. Megjithatë osht' ni e drejtë që mund ta shfrytëzoj njeriu. Po kjo nuk do të thotë që mund të ketë efekt.

Por, unë në atë kohë si i ri as nuk e kom konsideru si të drejtë, as nuk e kom konsiderue që mund të ketë të drejtë ankesa. Prandaj edhe nuk kam bërë ankese asniherë. Por, më është ulë dënimi pa ditë unë nga ç'arsye, për çfarë arsye e kanë zbrit dënimin nuk e di. Por jo për shkak të, për shkak se kam bërë ndonjë ankese apo ju kom nënshtru ndonji amnistie apo diçka. Ajo s'ka qenë as amnistie. E kom mbajtur dënimin. Shkalla e dytë e ka pru vendim që të më dënojnë gjashtë vite dhe të gjashtat i kom majtë.

Bile, bile, nja dy ditë ma shumë se gjashtë vjet. Sepse jam burgosë me 10 mars kur m'ka zanë në aksion edhe m'u osht' llogaritur burgu nga 12 mars, atëherë kur osht' fillu hetimet. Domethonë qato dy ditë ma tepër i kom majt. Edhe kemi bo shaka edhe me shokë edhe me të afërm që, shpesh herë iu kom thanë, "Nuk iu fali ato ditët që m'kanë majtë ma shumë". Faktikisht nuk ua fali as qato gjashtë vjet (qeshë) po kështu ishte ajo nga tetë vite në gjashtë vite.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë, qajo ditë kur keni dalë prej burgut qysh ka qenë? Edhe qysh keni, si me thanë, qysh jeni kthi deri në shpë?

Skender Vardari: Po, kanë ardhë, kanë ardhë me dy makina. Nuk kanë pritë. Shumica e anëtarëve të familjes edhe të afërmeve të mi kanë ardhë atje me më marrë me gzinimin që kanë përjetu familja kanë ardhë atje me dy makina të plota. Kanë ardhë atje më kanë pritë edhe jom kthi bashkë me ta. Në familje kem pasë, domethonë e kom ditë që osht' ni gzim i madh për familjen edhe për rrethin që kom pasë. Mirëpo, kanë dalë prej burgu në ni kohë shumë të vështirë që m'u është ngulitë në true, me të vërtetë, ka baza të, patjetër ka bazë të fortë ajo thanja e bacës Adem që, "Po dal prej burgut të vogël në burgun e madh". Atëherë, me të vërtetë Kosova në 1988-ën e ke parasysh? Sa vjeçare ishit ju?

Anita Susuri: S'kemi qenë ende...

Skender Vardari: Po, po.

Anita Susuri: '91-sh jam.

Skender Vardari: Po, po. Domethonë, ka qenë me të vërtetë burg me shumë dispozita vet Kosova, vet trojet shqiptare. Edhe kem pasë, te ne, ni domethonë, si traditë që kur të del dikush prej burgu me dalë me vizitue edhe të afërmit e familjes. Unë kom pasë të farefisit që s'kanë guxu me ardhë me më vizitue në atë kohë. Në mënyrë të fshehtë ni bijë e jona e familjes tonë që osht' martue diku tjetër ka dërgu fjalë edhe të fala, por në mënyrë të fshehtë përmes vllaut të vet. Ka thanë, "Skenderit boni të fala, nuk guxoj me ardhë me të pa". Grua e martume nuk guxon me ardhë me më pa, e farefisit tonë. Me të vetmën arsye se e ka pasë ajo burrin polic të asaj kohe me uniformë. Vetëm ni shembull e mora, po ka shumë shembuj të tjera që disa i di une. Por, jom e bindun që shumë tjera që nuk i di une, që nuk kanë ardhë me më vizitu me të njejtën arsye të mos guximit, të frikës që do të ketë pasoja edhe vizita e tyne për me m'pa mue.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe me bashkëshorten si jeni njoftu? A ka qenë problem që keni qenë ish i burgosur?

Skender Vardari: Po, po. Kur kom... kjo, njoftimi me bashkëshorten ka fillue shumë herët. Gjatë kohës sa isha une në shkollë të mesme. Jemi njoftë si të mitun. Kemi vazhdue simpatitë ndaj njëri-tjetrit. Mandej jemi njoftë, jemi njoftue, kemi fillue ni periudhë të jetës si dashnor edhe kur kom ra në burg une kemi qenë vetëm si dashnor. Tash edhe ktu do ta hapi një kaptinë të veçantë për shkak, jo për shkak si bashkëshorte e imja, por osht' ni karakteristikë që vlen të theksohet, sipas mendimit tim.

Po i kthehem asaj që kur jom burgosë jemi ndarë si bashkëshortë, si dashnorë deshta me thanë. Gjatë vujtjes së dënimit ka shku shumë vjet s'jemi pa. Kemi korrespondu kohë pas kohe me letra. Nji kohë të gjatë edhe pse e kam deshtë shumë m'u osht' sillë vërdallë në mendje që të heq dorë. Jo për shkak timin, por për shkak të saj, që të mos ketë pasoja në jetë ajo. E kisha si zgjidhje, domethonë ni alternativë e zgjidhjes ishte që të ndahem në mënyrë që të mos ketë pasoja ajo.

Këtë drejtim jom mundu me u përmbajtë edhe në letrat që i kom shkruar asaj. Por, ajo me këmbngulësi s'ka hjekë dorë. Jo vetëm s'ka hjekë dorë. Përmes letrave m'ka tregu që nuk heq dorë. Mandej, jemi fejue duke qenë une në burg ajo jashtë. Familja ime ka bërë ni fejesë timen me të, ka bërë ni, domethonë ni atmosferë të muzikës në shpi edhe ni aheng...

Anita Susuri: Gosti.

Skender Vardari: Ni gosti për fejesën tonë, vetëm në rrethin familjar. Ma vonë, edhe ajo nuk osht' mjaftue. Për bashkëshorten time nuk ka mjaftue të osht' ajo e fejumja e jemja. Ka insistue të martohemi...

Anita Susuri: Sa keni qenë në burg?

Skender Vardari: Të lidhim kurorë gjatë kohës së vujtjes time në burg nuk kemi arritë. As ajo s'ka arritë, as une prej burgut. Edhe une e kam konsiderue që si një ndër format e presionit që të bëj, të na bëj të vuaj më shumë edhe mu edhe bashkëshorten, domethonë pushteti i asaj kohe. Edhe kto e kam hjekë nga rendi i ditës vetëm për me ju tregue pushtetit që s'prish punë edhe që nuk jemi të, nuk e kemi të lidhun kurorën, ne jemi bashkëshortë. Ashtu jom sillë, ashtu kemi korrespodu me letra mes veti.

Kjo, domethonë, bashkëshortja duke mos qenë e mjaftueshme kjo gjendje, sepse ndikojke nëse nuk osht', nuk je e kurorëzume nuk ka pasë të drejtë vizite. Ne nuk jemi pa gjatë vujtjes së dënimit me bashkëshorten time, me dashnoren time, ma vonë me të fejumën. Edhe në fund osht' detyru ajo, ka marrë edhe një hap ma tutje, jo është detyru, por ka marrë një hap ma tutje vet. Ndërkohë, mu m'u kanë martue motrat që i kisha në shpi, më kanë mbetë nana edhe baba n'shpi edhe një motër e vogël. Bashkëshortja ime e ka lonë familjen e vet, ka ardhë që ta vazhdoj jetën si me qenë gru e imja...

Anita Susuri: Si nuse e shpisë.

Skender Vardari: Si nuse e shpisë, por pa qenë une në shpi. Une isha gjatë vujtjes së dënimit. Kur kom dalë prej burgu une bashkëshorten e kom gjetë në shpi.

Anita Susuri: A ka pasë prapë gosti, a diçka atë ditë që keni dalë prej burgut? Festë?

Skender Vardari: Po, po, po si festë. Por festë modeste, festë e kufizume, festë në qato rrethana. Domethonë, na, une me bashkëshorten jemi martue, jemi fejue pa bërë dasmë. Dasmë unë s'kom ba. Kem bo një gosti në rrethana shumë të vështira të 1988-ës edhe në një aheng tepër modest. Me njerëz [numër] tepër të kufizume të anëtarëve të familjes.

Anita Susuri: Më tregutë që në Turqi kur keni shku, keni pasë edhe atje vështirësi. Qysh ka qenë jeta për juve atje? Me çka jeni marrë? Qysh jeni gjetë?

Skender Vardari: Kur m'kanë përzanë prej Jugosllavisë, domethonë atë kohë kemi mrri para mëngjesit, para dyrve të hymjes së ndërtesës ku banonte njana motër. Në atë terrin, nga terri i natës deri në ag, ajo koha e agut, kur fillojnë të thirret ezani në të gjitha anët e xhamive që ekzistojnë në Stamboll në qetësinë absolute të mëngjesit mu më është dukë që jom i hedhun në një, në një bunar të pafund që nuk ka kthim mrapa. Qasi ndjenje kom pasë une për veti. Qishtu i kom fillue jetën në Stamboll.

Gjuhën turke ndërkohë e kam harru, nuk e dija mirë. Edhe filloi jeta, te motrat kom nejt vazhdimisht. Shtëpinë e kishim ktu, prindtë i kisha ktu. Prindtë ndërkohë në moshë të vjetër me probleme, domethonë shëndetësore të shumta, unë atje. I ndrrova disa punë, shumica prej tyre fizike. Me

përrjashtim kësaj të fundmes, gjeta një metodë që ta marrë ni leje atje, lejen e vozitjes të bëhem shofer kamioni. Me kamion si transportues kam fillue të jetoj në Turqi, në Stamboll deri pas luftës.

Ndërkohë, vitet '90-ta kur ke lind ti e knej që ka qenë rrethanat shumë të vështira edhe më tepër ekonomike. Pastaj ka fillu që të rëndohet kriza ekonomike në Kosovë me të madhe. Në kohën kur kanë dalë me të madhe jashtë dhe shqiptarë që kanë qenë shtetas të Jugosllavisë edhe ata kanë dalë. Domethonë, ni jetë që nuk ka pasë kurfarë perspektive në përgjithësi në Kosovë. Në ato rrethana na osht' dashtë prej prindtë e mi me e shitë shpinë që e kishim në Prishtinë.

E kemi shitë me ni çmim kështu shumë të vogël edhe më kanë ardhë prindtë atje në Stamboll deri pas luftës. Në momentin e parë, meniherë mas luftës gjithçka kom lanë atje edhe një ndër të partë që ka ardhë në Kosovë edhe për t'mu rrëqethë lëkura e trupit për me pa Kosovën m'u ulë me puthë tokën e Kosovës (qan).

Anita Susuri: Pas luftës kur jeni kthi në Kosovë, si e keni gjetë Kosovën edhe si keni fillu jetën?

Skender Vardari: Pas luftës, mundësinë e parë që m'u është dhanë meniherë jom kthye duke qenë shumë i papërmbajtur. Duke lanë edhe disa obligime, disa mundësi atje që kisha krijue ni sado kudo pak a shumë ni stabilitet fillestar do të thoja. Për shkak se edhe atje m'u vendosë, me fillu ni jetë me familje i ka vështirësitë e veta. Nuk është sikur kta që kanë dalë në perëndim, se perëndimi megjithatë ka pasë, kanë pasë ni mbështetje sociale nga shtetet që i kanë pranue edhe kanë startue pa pasë, pa pasë probleme të shumta sociale. Unë kto nuk i kom pasë në Turqi. Në Turqi i kom përjetu kto une vet, megjithë motrat e mija që i kisha atje edhe isha barrë edhe e tyne e tjera e tjera.

Mirëpo, kjo përfundoi edhe morëm rrugën për në Kosovë. Erdhëm me padurimin që e kishim edhe unë edhe bashkëshortja edhe fmitë. Edhe fmitë i kemi eduku në atë mënyrë, se harrova, se edhe kjo pjesë ndoshta ka rëndësi. Se gjatë kohës kur kom jetue më ka ra që të jetoj në Turqi gjashtë vjet e para luftës në Stamboll. Kto gjashtë vite fmitë u rritën, dy të partë, i treti lindi atje në Stamboll. Kta dy të partë u regjistrunë në shkollë gjithashtu në gjuhën turke. Siç e kisha përjetu une, me ni dallim që ata e dinin shqipen sepse në shpi flisnim vetëm shqip. Kurse fmitë në shkollë flisnin gjuhën turke.

Tri klasë të shkollës fillore djali edhe çika i kanë kry turqisht atje. Pas luftës tash po kthehem me fmi ktu. Me emocione shumë të mdhaja. Që në hymje të kufinit duke dalë prej derës të makinës, sepse me makinë erdhëm, duke e puthë tokën e Kosovës. Duke u mundu me më qetësu bashkëshortja që, mbaju se tani e tutje jemi në Kosovë e tjera. Hynëm. Ni gzim i papërshkrushëm. Por, kudo që depërtoje në brendësi që nga fillimi e deri në fund fshatra të tëra të djegura.

Njënën anë e kishe ni ndjenjë të papërshkrueshme gjithë ai dëmtim që është bo. Në anën tjetër sikur nuk t'bon shumë përshtypje ajo edhe pse shumë e djegur, por osht' e jotja. Tërë ditën me folë atë ndjenjë unë nuk di ta shpjegoj edhe të mirën edhe të keqën s'bashku. Sheh keq të djegun, fshatra të

tëra deri të vish në Prishtinë prej Hanit të Elezit domethonë në drejtim të Prishtinës. Në anën tjetër ke gzim. Rrugës autoblanda në lëvizje e sipër, hyjnë dalin njerëzit.

Kemi ardhë në Kosovë. Kemi vizitu njëherë të afërmit tonë që kishim të afërm tjerë plot në Kosovë, në Prishtinë, shokë, shoqe, çka kisha. Edhe fillum ta mendojmë se qysh do t'ia fillojmë jetës. Une para luftës gjatë tërë jetës e kisha atë profesionin të trashëgum nga babai si tregtar i frutave, perimeve në treg të Prishtinës. Thashë të filloj prej ktuhit. Edhe e kam konsiderue politikën punë të kryme për vete. Kur kam ardhë në Kosovë kam mendue që të mirrem vetëm me tregti në vendin tim. Tani e tutje pjesa e mbetur që duhet ta vazhdojnë vullnetarët që mirren me politikë, kurse vehtes sikur ia ndalova pothuasje në tërësi politikën.

Siç thashë, e mendova që të mos merrem me politikë edhe faktikisht mënyra e jetesës sime pas luftës ka qenë e tillë. Më se 90 përqind mund të them lirisht që nuk më ka interesue. Kom pasë besim të plotë që pas luftës do të jenë njerëzit e duhur ata që kanë mbetë, ata që e kanë vazhdue idealin tonë edhe gjatë luftës. Sepse kam ndi një boshllëk në vetvete që nuk kam marrë pjesë edhe në luftë. Se faktikisht unë nuk kom marrë pjesë në luftë. Edhe shihja që ka shumë njerëz që kanë marrë pjesë në luftë edhe që janë aktivë në politikë edhe i jipja të drejtë të gjithë atyre, sidomos ktij krahu të luftës që kanë luftue. Kisha bindje që kta së bashku me të tjerë, me politikanët e tjerë, do ta bëjnë politikën e duhur edhe në Kosovën e lirë.

Prandaj, mue është koha që të mos merrem me politikë, po t'i kthehem jetës të përditshme të tregtisë që e kisha trashëgue prej babës. Me këtë mendje, me këtë logjikë, me këtë mendësi e kam fillu jetën në Kosovë. Me plot vështirësi, domethonë. Ndërprerje të rrymës e mungesë e ushqimit, shpërndarja e ndihmave, ndërtimi i shtëpive atyne që ju është djegë. Kurse unë kom fillue duke qenë qiraxhi nëpër shtëpi të tjerëve prapë. Kështu kom fillu jetën. Nja dhetë vite e kom ushtru profesionin tim të tregtarit të frutave e perimeve.

Pas dhetë viteve e kom lanë punën, kom qenë i pa punë disa vite. Jo disa vite po ma shumë se dhetë vjet. Në këtë... qe ni vit e gjysmë e diçka jam ktu në shoqatë. E kanë pa shoktë e kryesisë së shoqatës të arsyeshme që të na thrrasin mu edhe ni koleg timin. Ta marrim përsipër konstruktimin e qitij arkivit të Kosovës, arkivit të Shoqatës për të Burgosur Politikë të Kosovës edhe me një pagë minimale. Jom i knaqun në punën që e boj, bile edhe me atë pagën minimale jom i knaqun. Edhe shpeshherë kur përhapen propaganda të ndryshme për ta lshu Kosovën për shkak të mos përspektivës në Kosovë, unë si në shaka ju them të mive, "Shkoni të gjithë! Do t'jem i fundit që do ta mbaj dritën ndezun, i fundit!" (qan).

Anita Susuri: Zotëri Skender, nëse s'keni diçka tjetër me shtu ju kisha falënderu shumë për intervistën, për kohën.

Skender Vardari: Ju falënderoj une juve për disa arsye. Arsyeja e parë është që ma dhatë mundësitë për herë të parë në jetën time të rrëfihem në vetën e parë, kjo është arsye ma kryesore që asniherë në jetën time në vetën e parë nuk kom folë. Edhe ju falënderoj edhe për durimin që e patët edhe ju jom falënderues edhe për shkak se i takoni ju gjeneratës së re e merrni me përkushtim një periudhë të jetës së një gjenerate që është mundu me bo diçka në kohën shumë të vështirë. Në kohën kur gjenerata e re mendon për veti edhe ka shumë probleme për veti. Edhe keni kohë për edhe interesimin për ni periodë të lavdishme për popullin shqiptar në Kosovë.

Anita Susuri: Faleminderit edhe njëherë.

Skender Vardari: Faleminderit shumë.